AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTE

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve në "Arte Muzikore" me profilet, "Mjeshtëri Piano", "Mjeshtëri instrumentësh me harqe"**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë**

**"Universiteti Europian i Tiranës"**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

1. Prof. Petrika Afezolli
2. Prof. Bujar Sykja

Nëntor 2022

**Për Programin e studimit Master i Arteve në "Arte Muzikore" me profilet, "Mjeshtëri Piano", "Mjeshtëri instrumentësh me harqe"**

| Nr. | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | UET |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Arteve të Aplikuara (Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale) |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Master i Arteve në "Arte Muzikore" me profilet, "Mjeshtëri Piano", "Mjeshtëri instrumentësh me harqe" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | UMASR Nr. 685 datë 15.10.2018 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | - |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli 2 |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 vite akademike/6 semsetra |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 120 (ECTS) |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 7 (shtatë) |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | V.A 2019-2020 – 3 PAE/4 PAK<br>V.A 2020-2021 – 4 PAE/3 PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | V.A 2019-2022 – 4 studentë të rregjistruar. |
| 19 | Komente / të tjera: | - |

## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Përshkrim përmbledhës;

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm në raportin përfundimtar të tij për vlerësimin e programit të studimit, Master i Arteve në "Arte Muzikore" me profilet, "Mjeshtëri Piano", "Mjeshtëri instrumentësh me harqe" në punën e tij me dokumentacionit e venë në dispozicion nga ana e Departamentit të Arteve të Aplikuara konstaton një nivel cilësor të paraqitjes së këtij dokumentacioni në përgjithësi dhe në veçanti për Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të këtij departamenti.

Para këtij fakti dëshirojmë të vemë në dije se një pjesë të mirë të rubrikave që do të plotësojmë për Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për këtë department në ciklin e dytë të studimit Master do të jenë citime me përdorim thonjëzash nga ana e atij Raporti të Brendshëm Vlerësimi.

Programi ciklit të dytë të studimit Master në "Arte Muzikore" me profile është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinise, Nr.685, datë 15.10.2018. Programi ofrohet nga Departamenti i Arteve të Aplikuara, njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale i liçensuar me VKM Nr.636, datë 20.09.2006 dhe i riorganizuar me urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr 528, datë 04.09.2018. Fillimisht programi është ofruar me 5 profile, por aktualisht në proçes akreditimi do të jenë 2 nga profilet fillestare. Programi i studimit filloi veprimtari në akademike në vitin akademik 2019-2020 dhe është në proçes akreditimi për herë të parë.

"Programi i studimit realizohet me 120 (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohë zgjatje normale 2 vite akademike (4-semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diploma: "Master i Arteve" në"Arte Muzikore" me profile: "Mjeshtri Piano", "Mjeshtri instrumentash me harqe".

Programi ciklit të dytë të studimit Master i Arteve në "Arte Muzikore"sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshem,"objektiv kryesor" ka formimin e "ekspertëve dhe specialistëve" me "njohuri themelore teorike, me praktikat bashkëkohore ndërkombëtare si dhe ato shqiptare ku studentët do marrin njohuri të thelluara në disiplinat e mësipërme, gjë e cila u mundëson atyre të jenë më të përgatitur me kriteret e punësimit që kërkohen në këtë sektor. Programi ciklit të dytë të studimit Master i Arteve në Arte Muzikore sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm ka aftësi të përgjithshme praktike, aplikative, synime të qarta për t'i pajisur studentët me "njohuri dhe koncepte të thelluara të fushës së studimit Arte Muzikore, aftësi drejt një profesioni apo liçence profesionale në fushën e Arteve Muzikore në formimin qytetar të përgjthshëm, aftësi bazë për punë kërkimore, synime për nga specifika dhe struktura mësimore e paraqitur në Departamentin e Arteve të Aplikuara, ky program studimi, Master në "Arte Muzikore me profile" është relativisht e pamjaftueshme për këtë "synim".

## Përshkrimi i proçesit të vlerësimit të jashtëm;

Në përmbushje të detyrimeve ligjore mbi akreditimin e programeve të studimit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) në Urdhërin Nr.27 datë 15.03.2022 me Nr.87/6 Prot.ka nisur proçesin e vlerësimit të jashtëm për programin e studimit Master i Arteve në Arte Muzikore, me profile në UET, Departamenti i Arteve të Aplikuara, njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale.

Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhet nga: Prof. Petrika Afezolli dhe Prof. Bujar Sykja. Detyra e ekspertëve të jashtëm ishte përpilimi i raportit të vlerësimit të jashtëm, mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit të përcjellë nga institucioni dhe gjetjeve gjatë kryerjes së vizitës në institucion. Grupi i punës u mbështet gjatë gjithë procesit të vlerësimit të jashtëm nga koordinatori teknik i ASCAL, Msc. Arjana Alija.

Në punën për hartimin e Raportit, Grupi ka vepruar me ndarje punë sipas guidës së ASCAL-it ku detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara janë qartësuar për secilin anëtar. U konsultuam me Personelin Akademik dhe Studentët,Anëtarët e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm,Dekanin dhe Përgjegjësin e Departamentit për të prekur nga afër problematikat në përmbajtjen akademike të programit,në cilësinë e personelit akademik për realizimin e tij,në vlerësimin e infrastrukturës dhe mjediset në dispozicion,si dhe në parametra të tjerë me rëndësi për proçesin e akreditimit.

Grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse,në mënyre të veçantë udhëzimet e ASCAL-it, si dhe ka shfrytëzuar dokumente e brendshme të UET-it. Grupit i janë vënë në dispozicion dhe ka shfrytëzuar në mënyrë racionale të dhënat që nevojiten për proçesin e akreditimit përfshirë dhe rekomandimet e specialistit që Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin,Sportin dhe Rinisë (Drejtoria e Derregullimit, Liçencave dhe Monitorimit) me Nr.11373 Prot me datë 29.10.2018 i rekomandon UET-it ku citon që: *"Rekomandimet e ekspertëve nevojiten të plotësohen para fillimit të veprimatrisë së programit të studimit përkatës, ndërsa rekomandimet për sigurimin e marrëveshjeve të bashkepunimit me institucione të tjera për zhvillimin e praktikave profesionale,të sigurohen të pakten një muaj para fillimit të tyre".*

Pjesa më e madhe e problematikave që u vunë re dhe që do detajohen në Raportin e Vlerësimit të Jashtëm konsatojmë që janë të detajuara në Rekomandimet e Specialistit që me datë 29.10.2018Nr.11373 Prot dërguar UET-it nga Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rinisë (Drejtoria e Derregullimit,Liçencave dhe Monitorimit).

*"Universiteti Europian i Tiranës" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 14.09.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 87/100 Prot, datë 14.09.2022. "Universiteti Europian i Tiranës" përcjell në ASCAL komentet përmes AMS dhe me anë të shkresës me Nr. 78/118 Prot., datë 03.10.2022, "Kthim përgjigje mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm".*

**GVJ pasi u njoh me komentet e IAL-së mbi Draft – RVJ e programit të studimit: Master i Arteve në "Arte Muzikore" me profilet, "Mjeshtëri Piano", "Mjeshtëri instrumentesh me harqe", sqaron si vijon:**

Në të dhënat e përgjithshme për programin e studimit në proçesin e vlerësimit të jashtëm dëshirojmë t'ju kujtojmë se një pjesë të mirë rubrikave,i kemi plotësuar duke ju referuar RVB-së së UET-it dhe për RVJ-në për këtë department në ciklin e dytë të studimit Master kemi përdorur citime me përdorim thonjëzash nga ana e jonë, kështu:

Në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, programi ciklit të dytë të studimit Master i Arteve në "Arte Muzikore" me profilet, "Mjeshtëri Piano", "Mjeshtëri instrumentesh me harqe" sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm,"*objektiv kryesor ka formimin e ekspertëve dhe specialistëve me njohuri themelore teorike, me praktikat bashkëkohore ndërkombëtare si dhe ato shqiptare ku studentët do marrin njohuri të thelluara në disiplinat e mësipërme, gjë e cila u mundëson atyre të jenë më të përgatitur me kriteret e punësimit që kërkohen në këtë sektor. Ky program ka aftësi të përgjithshme praktike,aplikative,synime të qarta për ti pajisur studentët me njohuri dhe koncepte të thelluara të fushës së studimit Arte Muzikore, aftësi drejt një profesioni apo liçence profesionale në fushën e Arte Muzikore, në formimin qytetar të përgjithshëm, aftësi bazë për punë kërkimore".*

**Në RVJ ne u shprehëm se: "... ky objektiv kryesor për nga specifika dhe struktura mësimore e paraqitur në "Departamentin e Arteve të Aplikuara" është i pamjaftueshëm"** duke u nisur nga ky konstatim do të argumentojmë dhe njëherë objeksionet tona referuar dhe relacionit tuaj:

**1-GVJ në RVJ – Standardi I.1/ Kriteri 3, 5.**

**2-GVJ në RVJ – Standardi I.2/ Kriteri 3.**

**3-GVJ në RVJ – Standardi I.3/ Kriteri 1, 2, 4, 5, 6.**

**4-GVJ në RVJ – Standardi I.4/ Kriteri 2, 3.**

**5-GVJ në RVJ – Standardi II.1/ Kriteri 2, 4, 6.**

**6-GVJ në RVJ – Standardi II.3/ Kriteri 2, 3, 6, 7.**

**7-GVJ në RVJ – Standardi II.4/ Kriteri 1, 6, 8, 10.**

**I- Koment nga Universiteti:**

Duke respektuar mendimin profesional të Ekspertëve, sqarojmë se në hartimin dhe zhvillimin e programeve të studimit të ofruara nga Departamenti i Arteve të Aplikuara në UET dhe konkretisht dhe në programin Master i Arteve "Arte Muzikore" me profilet, "Mjeshtëri Piano", "Mjeshtëri instrumentesh me harqe", UET ofron një program studimi sikurse ofrohet edhe nga Universitete apo kolegje të tjera në botë, i cili dallon nga programe të një natyre tjetër që ofrohen zakonisht nga shkollat Konservatore. Modele të ngjashme programesh të tilla që ndërtohen mbi të njëjtën frymë dhe filozofi ka shumë në botë dhe mund të përmëndim disa, si:

- Victoria University-Master of Musical Arts (M.M.A),Wellington, Zelanda e Re.
- Borys Grinchenko Kyiv University, Ukrahinë,
- Akademia superiore e Santa Cecilia, Romë,
- Universiteti i Vjenës.
- Konservarori Superior i Gjenevës.
- Konservatori Superior i Bukureshtit, Rumani.

**Komente nga GVJ**

1-Për sa më sipër, ky **Koment nga Universiteti**, faqja nr.1 paragrafi i parë se: "mendimi profesional i ekspertëve të respektuar" nga fjalitë e shkruara e në vazhdim nuk korrespondon me komentet e tij, kështu:

1.1-Në punën e GVJ ka qenë vetëm në respektim të ligjit 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse dhe në analizën e tij nuk ka ngatarruar "Shkollat Konservator" me Universitete.

2-Në faqen 1 paragrafi i dytë ku listohen emra të ndryshëm Universitetesh, Akademish, Konservator dhe në analizën tonë referuar linqeve të tyre na rezulton se këto institucione numrin e ECTS-ve për Master në specialitet Violine, Piano e kanë respektivisht nga 33-36-60 ECTS për dy vite, ndryshe nga programi i studimit MA "Arte Muzikore" me profile i UET-it që e ka 18 ECTS (në dy vite MA), kështu sugjerimi jonë që "Profili i diplomës"

1-Mjeshtri Piano

2-Mjeshtri instrumentash me harqe, nuk mund të qëndrojë me këtë emërtesë në modulin C pasi është vlerë e modulit B dhe një pjesë e Lëndëve Karakterizuese te moduli B duhet të integrohen në një koncept ndyshe, pasi ky profil diplome dhe emërtese që nuk egziston, studentit do ti nxjerr probleme në tregun e punës pasi elementi i parë i numrit të 18 ECTS-ve nuk është i mjaftueshëm për të konkuruar denjësisht në të.

**Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.**

2.1- Në këto Universitete, Akademi konservatore referuar linqeve të tyre na rezulton se këto institucione në përfundim të ciklit të dytë lëshojnë diploma **"Master"** me këto emërtesa si:

**"Diploma in Instrumental studies major in Violin",**

**"Master of music in Performance",**

**"Diploma in violin[1]",**

**"Piano Artist Performance Graduate Diploma"**

Ndërsa referuar Statutit të UET-it Kreu IV Studimet Universitare neni 32 Programet e ciklit të dytë të studimeve pika 32.1/32.2/32.3/32.5/32.6 lëshohet diploma "Master i shkencave" në fushën e arsimit të kryer, sipas rregullores së UET-it Kreu IX Diplomimi neni 38, Diplomat pika 38.3 "Master i Arteve" dhe Urdhërit të MASR NR.685 datë 25.10.2018 për hapjen e programit te ciklit dytë të studimit **Master i Arteve në "Arte Muzikore" me profilet, "Mjeshtëri Piano", "Mjeshtëri instrumentesh me harqe"**

Duke qenë se këto emërtesa që nuk egzistojnë,në funksion të realizimit të proçesit mësimor dhe strukturave akademike, do të konkurojnë në tregun e punës dhe bashkëngjitur me suplementët e lëndëve të zhvilluar në to, seleksionimi i tyre pozitiv do të jetë më i vështirë

**Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.**

## II- Koment nga Universiteti:

"Personeli akademik që punoi për hartimin e kurrikulave përpara hapjes së tyre në vitin 2018-2019, u mbështet në përvojën e Akademisë së Arteve në Tiranë, por nuk u përpoq të dublikonte ofertën akademike të këtij institucionui,pasi iu referua modeleve alternative që ekzistojnë sot në Europë e më gjërë,që i përshtatesin më shumë ofrimit të këtyre lloj programeve nga një institucion i natyrës universitet sikurse është UET".

**Komente nga GVJ**

-Në lidhje me këtë paragraf dëshirojmë të kujtojmë faktin se Akademia e Arteve në vitin 2018-2019 nuk egzistonte dhe ai institucion në atë kohë ka qenë Universitet i rikonceptuar me Ligjin e Arsimit të Lartë nr.80/2015, datë 22.07.2015

**Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.**

## III- Koment nga Universiteti:

**"**Departamenti i Arteve të Aplikuara ka objektiv përmisimin e vazhdueshëm të programit.Si evidencë për një praktikë të tillë përmisimi, sjellim në vëmëndje se janë adresuar rekomandimiet

[1] -Në Akademia Superiore të Santa Cecilia, Romë studenti fiton 54CFA në Bachelor. Në sistemin Italian të vlerësimit të krediteve egzistojnë dy sisteme të ndryshme:"kreditet formale të universitetit(CFU)dhe kreditet formale akademike (CFA) për institucione të nivelit të lart artistiko-muzikor".Të dy sistemet bazohen në konceptin e "ngarkesës në punë" dhe të dyja janë të barasvlefshme me sistemin europian të ECTS-ve.

e Ekspertëve gjatë licencimit dërguar me njoftimin zyrtar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit(Shtator 2018).Pas propozimeve ato janë miratuar në Senatin Akademik të Universitetit.

Dokumentacioni shtesë Ref.:

**-Vendim Dekanati Nr.92 Datë 03.12.2018,për miratimin e disa ndryshimeve në kurrikulat e ofruara nga DAA.**

**-Vendim Senati Nr.02.Prot datë 06.02.2019,Për pëmisimin e disa ndryshimeve në programet e studimit.**

Për sa më sipër, lutemi të rishikohet edhe njëherë në këtë aspekt vlerësimi i Ekspertëve në draft-Raportin e VJ".

**Komente nga GVJ** Për sa më sipër, për këtë koment nga Universiteti duke ju referuar materialeve që na janë vënë në dispozicion duam të kujtojmë se:

**1**-Në vendimi nr. 92 datë 03.12.2018 i Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve

Liberale në pikën 2 të tij flet për programin e ciklit të parë Bachelor.

**2-** Urdhërit të MASR NR.685 datë 25.10.2018 për hapjen e programit të ciklit dytë të studimit **Master i Arteve në "Arte Muzikore" me profilet, "Mjeshtëri Piano", "Mjeshtëri instrumentesh me harqe"** Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale në Vendimin nr. 92 datë 03.12.2018 këtë urdhër nuk e ka zbatur plotësisht (referuar pikës 3 të tij: **UET-ti të plotësojë rekomandimet e ekspertit**) dhe indirekt e ka kundërshtuar,pasi pika 2 fjalia e dytë sipas **"sugjerimeve të mjeshtrave të fushës përkatëse u miratuan ndryshimet e mëposhtme"** të cilat janë shumë pak të ndryshuara dhe nuk kanë reflektuar këto sugjerime.

Me keqardhje vihet re se shënimet e bëra nga GVJ përafërsojnë dhe kanë të njëjtin fokus.

Në Ligjin e Arsimit të Lartë nr.80/2015, datë 22.07.2015 terma të tillë si **"Mjeshtra të fushës"** të cilët gëzojnë reputacionin specifik, por janë të pareferueshëm në fushën akademike, pasi produkti i IAL matet nga zbatushmëria e tyre.

Në rekomandimet e ekspertit që bëri vlerësimin për hapjen e programit në ciklin e dytë Master në "Arte Muzikore" (përcjellë me shkresën e MASR Nr 11373 prot, datë 29/10/2018) **lexojmë një faqe me sugjerime** nga të cilat shumë pak janë demostruar në vendimin e Dekanatit Nr.92 datë 03.12.2018.

**Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.**

## IV- Koment nga Universiteti:

Argumentimi dhe baza ligjore e dhënë në draft-RVJ (Ligji nr.80/2015, Neni 83, Pika 3 dhe 4) i referohet programeve të ciklit të dytë të studimeve,në fushën e mësuesisë.Punësimi në këtë fushë bëhet sipas legjislacionit për profesionet e rregulluara për të cilat Universiteti është koshient se si dhe për cilat programe studimi aplikohen.

Studentët që përfundojnë ciklin e dytë të studimeve "Master i Arteve"në "Arte Muzikore" ,në UET,për t'u punësuar si mësues sipas legjislacionit në fuqi, mund të ndjekin studimet në ciklin e dytë në një program mësuesie në fushën përkatëse të studimit.

**Komente nga GVJ.**

Për sa më sipër, për këtë koment nga Universiteti duke ju referuar materialeve që na janë vënë në dispozicion duam të kujtojmë se:

1-Në sillabuset respektive të programit Master cikli i dytë në programin e lëndës Mjeshtri instrumentash me Harqe II, Instrumentacion dhe orkestracion,Mjeshtri PianoII, termat **"të japin mësim", " aftësi mësimdhënie", "nocionet e para të pedagogjisë në bashkëveprim me nxënësit "** na deturuan ti referohemi ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë nenit 83, pika 3,4.

**Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.**

**V- Koment nga Universiteti:**

Lutemi që GVJ të rishikojë vlerësimet e mësipërme,pasi në gjykimin tonë si Prof.As. Edith Mihali, e angazhuar në leksione dhe MSc. Zh.Ciko angazhuar në seminaret e kësaj lënde, kanë përvojë të pasur në fushën e pedagogjisë muzikore, skenës muzikore dhe drejtimin e institucioneve qëndrore të artit muzikor ku kanë ndërtuar dhe vijojnë të ndërtojnë karrierën artistët më në zë të skenës muzikore shqiptare.

**Komente nga GVJ.**

Për sa më sipër, për këtë koment nga Universiteti duke ju referuar materialeve që na janë vënë në dispozicion duam të kujtojmë se:

Syllabusi i Pedagogjisë i paraqitur në format PDF titulli lexon PEDAGOGJIA MUZIKORE ndërsa brenda faqes së parë lexojmë: INSTRUMENTACION DHE ORKESTRACION titullari i lëndës Prof.as. Ramazan Peku/Msc Zhani Ciko... nëse ka përditësim tjetër të na vihej në diaspozicion.

Përsa i përket paragrafit të fundit të Komentit të Universitetit, GVJ-ja ka kërkuar që "pedagogu nuk demostronte asnjë lidhje me lëndën që jepte" dhe sipas syllabusit bëhet fjalë për MSc.Zh.Ciko.

Përgjigja koncize nga universiteti dhe zyra e burimeve njerzore do të ishte e thjeshtë dhe e shkurtër: në listën e notave të MSc Zh.Ciko lënda pedagogji muzikore listohet po apo jo.... përsa i përket opinionit të paraqitur e me doza subjektiviste, ku citohet : "kanë një përvojë të pasur në fushën e pedagogjisë muzikore, skenës muzikore dhe drejtimin e institucioneve qëndrore të artit muzikor ku kanë ndërtuar dhe vijojnë të ndërtojnë karrierën artistët më në zë të skenës muzikore shqiptare",

në IAL flasin gradat akademike, proçedurat, demostrimi dhe standartet e fitimit të tyre pasi opinioni nga objekti i lëndës së pedagogjisë me atë që shpreh Universiteti janë shumë larg, duke përfituar nga rasti pasi në diskutimet tona me stafin akademik në programin e studimit: Bachelor në Arte Muzikore me profile, sugjeruam që një pjesë e mirë e lëndeve teorike duhen të kenë teksin bazë përfshi dhe atë pedagogjisë muzikore , do ju paraqes objektin e kësaj lënde i cili është i përfshirë si teks bazë në librin me po të njejtin titull të Dr.Edmond Buharaja.

**Pedagogjia Muzikore**

Objektivi është (a) "pedagogjia" dhe (b) "muzika" të cilat zhvillohen në tre drejtime: (i) mjeshtria e edukimit muzikor, (ii) shkenca e artit muzikor, (iii) fizolofia e shkencës muzikore.
Pedagogjia është teoria që studion çështjet e formimit të njeriut. Pedagogjia është kthyer në shkencë kur iu largua kufizimit të së qenurit një mjedis i pavarur hulumtimi, e kështu iu hap edhe aparateve metodologjike të shkencave të tjera, instrumenteve të ndryshme.
**Çështje**:

A) Ndërrimi i emërtesës në «**Pedagogjia e Muzikës**», «**Didaktika e Muzikës**», «**Pedagogjia e formimit muzikor**», «**Didaktika e edukimit dhe formimit muzikor**»,
Duke parë që në strukturën e disiplinës kanë gjetur vend edhe lëndë si psikologjia, antropologjia, sociologjia, emërtesa mund të jetë edhe «**Shkenca e edukimit dhe formimit muzikor**».

B) Të plotësohet me ciklin 5-vjeçar, pasi nuk mund të kemi dy standarte për të njëjtënn situatë, e në këtë rast emërtesa mund të përfshijë termin "Pedagogji", nëse mbetet katërvjeçar të kalojë në nivelin e didaktikës.

C) Të përcaktohet drejtimin që do t'i japim pedagogjisë: (i) metoda Kodaly — patrimonie e UNESCO-s — (synon ruajtjen dhe përhapjen e muzikës folklorike, ndaj synon ekspozimin ndaj muzikës folklorike qysh në moshë të vogël) o (ii) Orff — synon kryesisht elementin ritmik të muzikës dhe ndikimin e tij në lëvizjen, në zërin dhe në muzikën instrumentale.

**Komenti nuk merret parasysh dhe GVJ nuk ndryshon vlerësimin.**

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve në "Arte Muzikore" me profilet, "Mjeshtëri Piano", "Mjeshtëri instrumentash me harqe".

## I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të larte ofron program studimi "Master i shkencave"/"Master i arteve", në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e intëresave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ofron program studimi "Master i shkencave"/"Master i arteve" që nuk bien ndesh me intëresat kombëtare. | Në programin e ciklit të dytë të studimit Master i Arteve në "Arte Muzikore",me profile, mjeshtri Piano,mjeshtri Instrumentash me Harqe është përgatitur në përputhje me nevojat e kohës dhe me interesat kombëtare dhe vlerat kulturore kombëtare (siç është e shkruar në raportin e vlerësimit të brendshëm të UET[2]) dhe synon të kontribuojë për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare. Vihet re përpjekja për tu përshtatur me zhvillimet e vrullshme të shoqërisë shqiptare si dhe duke u mbështetur në ligjin e arsimit lartë[3]. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Në programin e ciklit të dytë të studimit Master i Arteve,në "Arte Muzikore",me profile, mjeshtri Piano,mjeshtri Instrumentash me Harqe,demonstrojnë të jenë në përputhje me Politikën e UET si dhe tregojnë qartë në mënyrë të dokumentuar qëllimin.<br>Ky program i shërben shoqërisë shqiptare me kreativitetin,shfrytëzimin më të mirë të mundshëm të arritjeve të shkencës shqiptare dhe shërben në mënyrë të qartë për tregun e punës brenda e jashtë vendit[4]. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Në programin e ciklit të dytë të studimit Master i Arteve në "Arte Muzikore" me profile, mjeshtri Piano,mjeshtri Instrumentash me Harqe, |

[1]Statuti I UET, neni 6 (Ref.nr.2).

[2]Plani Strategjik, 2015-2020, Vizioni (Ref.nr.3).

[3]Statuti I UET, neni 6, pika 6.2(Ref.nr.2).

| | |
|---|---|
| | në elementët "macro"janë në përputhje me politikën e UET[5] pasi plotëson profilin dhe ofertën akademike të Fakultetit i Shkencave Humane,Edukimit dhe Arteve Liberale,Departamenti i Arteve të Aplikuara. Ky program synon të formojë studentë të aftë dhe ofron mundësi për rritje të aftësive dhe eksperiencës së tyre në vazhdimësi,por syllabuset dhe struktura mësimore kanë nëvojë për një kolaudim më vertikal. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. | Duke shqyrtuar programin e ciklit të dytë të studimit Master i Arteve,në "Arte Muzikore"me profile, mjeshtri Piano, mjeshtri Instrumentash me Harqe, vihet re qartë se studentëve i ofrohet mundësia për të kontribuar në zhvillimet e politikave artistike[6] lokale e kombëtare duke qenë në përputhje me politikën e UET si dhe në përputhje me ligjin e Arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë . |
| **Kriteri 5.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor | Në programin e ciklit të dytë të studimit Master i Arteve,në "Arte Muzikore",me profile, mjeshtri Piano,mjeshtri Instrumentash me Harqe, vihet re përpjekje për të krijuar baza të qëndrueshme për studime të thelluara në ciklin e tretë,por syllabuset dhe struktura mësimore kanë nëvojë për një kolaudim më vertikal që ti shërbejnë më shumë ciklit të tretë[7]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi I.2**<br>**Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të larte dhe fushat akademike të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni përcakton qarte se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit. | Nga dokumentët e shqyrtuara vërejmë se grupi i punës së vlerësimit të brendshëm ka mbajtur mirë parasysh vizionin, prioritetet dhe objektivat të planit strategjik për zhvillimin e institucionit (UET) për vitet 2020-2025)[8]. |

[5]Statuti I UET,neni6,pika 6.3(Ref.nr.2)

[6]Rregullore e programit te studimit MA Arte Muzikore,Pika 3.3(Ref.Nr.7)

[7]Plani Strategjik,2015-2020, (Ref.nr.3);Plani Strategjik,2021-2025, (Ref.nr.3.1)
[8]Plani Strategjik,2015-2020, (Ref.nr.3);Plani Strategjik,2021-2025, (Ref.nr.3.1)

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qarte drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit. | Drejtimet prioritare akademike[9] të përcaktuara në statut e UET-it në përgjithësi dhe në rregulloren e programit të studimit Master në Artet Muzikore,me profile në veçanti, demonstrojnë vizionin për të ndërtuar një qendër ekspertize të specializuar duke mbetur të hapur për të ofruar dhe drejtime të reja sipas kërkesës së tregut të punës pasi UET ka mundësi njërëzore e financiare . |
| **Kriteri 3.** Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. | Organizimi,emërtimi, përmbajtja e programit të studimit në departamentin e Arteve të Aplikuara në UET është në përputhje me legjislacionin në fuqi[10].<br>Struktura dhe lëndët që zhvillohen janë bazuar në VKM-në Nr.41 datë 24.1.2018 të ndara në:<br>1-Lëndë bazë<br>2- Lëndë Karakterizuese<br>3- Lëndë ndërdisiplinore integruese<br>4-Lëndë plotësuese<br>5- detyrime përmbyllëse por,të gjitha këto lëndë kanë nëvojë për një ristrukturim të ri sepse "Profili" i diplomës nuk mund të qëndrojë në modulin C pasi është vlerë e modulit B dhe një pjesë e Lëndëve Karakterizuese te moduli B duhet të integrohen në një koncept ndryshe, pasi ky profil diplome do ti nxjerrë studentit probleme në tregun e punës[11]:<br>a-Diploma me profil "mjështëri në piano"dhe "mjeshtëri në instrumenta me harqe"janë emërtësa *që nuk egzistojnë* në terminologjinë e syllabuseve dhe kur i krahason me emërtesat e programeve të studimit të universiteteve si brenda dhe jashtë vendit është një faktor më shumë në vështirësitë e njohjes dhe ekuivalentimit të ECTS-ve në rast të transferimi të studentëve nga një universitët në një tjetër.<br>b-Numri 36 i ECTS-ve nuk është i mjaftueshëm për të konkuruar denjësisht në tregun e punës dhe për më shumë të konvertosh termin "mjështëri në piano" apo "mjështëri në instrumenta me harqe" kur syllabuset përkatëse nuk justifikojnë ngarkesën dhe kreditet e përfituara nga studenti për dy vite. |

[9]Statuti I UET,neni6.3(Ref.nr.2).Rregullore e UET,neni 4(Ref.nr.5); Plani Strategjik,2015-2020,Objektivat strategjike(Ref.nr.3)

[10]Aktet ligjore:VKMNr.41,datë 24.01.2018"Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga ILA i ndryshuar (Ref.nr.53.1 dhe 53.2)

[11]Aktet ligjore:VKMNr.41,datë 24.01.2018"Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga ILA i ndryshuar (Ref.nr.53.1 dhe 53.2)

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kriteri 4.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, intëresit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit | Nga dokumentët e shqyrtuara vërejme se vizioni, prioritetet dhe objektivat të planit strategjik për zhvillimin e institucionit (UET) për vitet 2020-2025[10] zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit dhe trendet globale të zhvillimit. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi I.3**<br>**Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon të plotësojë nëvojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" ka objektiva të përcaktuar qarte për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës. | Programi i ciklit të dytë të studimit Master i Arteve në "Arte Muzikore" me profile, mjeshtri Piano, mjeshtri Instrumentash me Harqe është në përputhje me politiken e UET pasi plotëson profilin dhe ofertën akademike të Departamentit të Arteve të Aplikuara[12], por struktura mësimore dhe syllabuset kanë nevoje për një kolaudim pasi "objektivi kryesor" i këtij programi që "student të marrin njohuri të thelluara në disiplinat e përcaktuara me profile" dhe me emertesa"lëndë individuale artistike",nuk korrespondon me numrin e 36 të ECST-ve të këtyre diplomave në Master që ofrojnë njohuri " të thelluara". Objektivi nga Realizimi kanë nevojë të rishikohen. |
| **Kriteri 2.** Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nëvojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real | Refetuar Statutit UET[13]-it duket qartë se ky ILA ka një konsultë institucionale nëpërmjet Bordit për studimin e tregut të punës[14] me departamentin e Arteve të Aplikuara i cili mblidhet së paku 2 herë në vit për të konsultuar pritshmëritë e tregut në raport me programet si dhe krijon mundësi për praktika në institucione (kryesisht private). Gjithashtu në UET është shoqata UET ALUMNI e cila mban kontakte me studentët e mëparshëm dhe konsulton eksperiencat e tyre.... Ky department demostron se ka përvojën, kapacitetet dhe |

[12]Rregullore e programit te studimit MA Arte Muzikore,Pika 3.3

&Aneks I(Ref.Nr.7)

[13]Argumenti për hapjen e programit MA Arte Muzikore(Ref.Nr.16) Statuti I UET,neni 18,pika 18.3(Ref.nr.2)

[14]Argumenti për hapjen e programit MA Arte Muzikore(Ref.Nr.16) Statuti I UET,neni 18,pika 18.3(Ref.nr.2)

| | |
|---|---|
| të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. | burimet e duhura në fushën akademike specifike, por Diploma Master me dije "të thelluara" dhe referuar syllabusit në "tregun publik"do të këtë problem pasi bazuar në kërkesat e Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015"Për Arsimin e Lartëdhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"neni 83(programet e mësimit në fushën e mësuesisë) pika 3, 4 kjo strukturë nuk përmban asnjë element për këtë profil Diplome. |
| **Kriteri 3.** Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetëncave që i përgjigjen nëvojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. | Objektivat formuese dhe kompetencat profesionale në përgjithësi gjenin vend në strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit[15]ku si ato"përcaktuese"[16]-[të cilat janë të njëta për programe studimi me të njëjtin emërtim të ofruar nga ILA të ndryshme] dhe ato "Specifike"[15]-[të cilat diferencojnë programet e studimit me të njëjtin emërtim të ofruar nga ILA të ndryshme]...ishin bashkerenduar në Master kryesisht saktë. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar. | UET në strategjinë e tij të përafrimit të programeve të studimit me ILA ndërkombëtare dallohet në ndërtimin prespektiv të tyre por me sugjerimet e bëra kolaudimi i lëndeve në strukturën mësimore do jetë më efektiv dhe realist. |
| **Kriteri 5.** Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e larte dhe profesionët e rregulluara, mbështëtët në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropianë. | Programi i ciklit të dytë të studimit Master i Arteve,në "Arte Muzikore",me profile, mjeshtri Piano,mjeshtri Instrumentash me Harqe,është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi,sikurse dhe direktivat e kartës se Bolonjës duke shfrytëzuar dhe eksperiencën e UET-it disa vjeçare,por koha e pakët në funksionim të këtij Masteri ka nevojë për rishikime dhe rikolaudime. |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionët e rregulluara. | Programi i ciklit të dytë të studimit Master i Arteve,në "Arte Muzikore",me profile, mjeshtri Piano,mjeshtri Instrumentash me Harqe përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit .UET e konsideron si një nga sukseset e realizimit të praktikave profesionale,por përditësimi me elementë akoma më bashkëkohorë dhe funksional do të ishte në kolaudimin e strukturës mësimore[17]. |

[15]Rregullore e programit te studimit MA Arte Muzikore,Pika 3.3

&Aneks I(Ref.Nr.7)

[16]VKM Nr.41 date 24.1.2018 për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL. VKM Nr.41 date 24.1.2018 per elementet e programeve te studimit te ofruara nga ILA.

[17]Rregullore e programit te studimit MA Arte Muzikore,Pika 3.3

| | |
|---|---|
| **Kriteri 7.** Në programin e studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", duhet të përfshihen elementë të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit. | Programi i ciklit të dytë të studimit Master i Arteve në "Arte Muzikore",me profile, mjeshtri Piano,mjeshtri Instrumentash me Harqe ofrohen në gjuhën Shqipe, në përputhje me aktin e liçensimit,megjithatë me qëllim nxitjen e shkëmbimit të studentëve me ILA partner,lëndët të ndryshme ofrohen në gjuhen Angleze[18]për studentë që ofrohen me bashkepunime semestrale. |
| **Kriteri 8.** Për programin studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze | Programet e lëndeve hartohen në gjuhen Shqipe dhe në version të shkurtuar në gjuhën Angleze. Ato dorëzohen tek koordinatori i departamentit i cili i hedh në "Dokumenta UET", duke qenë të aksesueshme në internet.I gjithë dokumentacioni arkivohet në zyrën e Sekretarisë së përgjithshme dhe ruhen pa afat. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi I.4**<br>**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetët dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | UET në përgjithësi dhe departamenti i Arteve të Aplikuara në veçanti ka kapacitetet akademike specifike në fushën e arteve muzikore[19] (janë pjesë e stafit pedagogjik emra të njohur të artit shqiptar) si dhe infrastukturë teknologjike e financiare për ofrimin e këtyre programeve. |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit | Konstatojmë se programet Master i Arteve në "Arte Muzikore" me profile ishin hartuar nga departamenti i Arteve të Aplikuara pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Edukimit dhe Arteve Liberale[20]. Fushat e përgjithshme dhe specifike ishin të bashkrenduar saktë. |

Aneks I (Ref.Nr.7)

[18]Plani Strategjik,2021-2025,Prioritetet në bashkëpunimin dhe kooperimin ndërkombëtar,pika 3 (Ref.nr.3)

[19]Të dhëna tabelore për personelin akademik në FSHHEAL dhe Departamentin e Arteve të Aplikuara (Ref.Nr.23);Infrastruktura në funksion të programeve të studimit(Ref.nr.42);Të ardhura dhe financime të ndryshme(Ref.nr.50-50.6)

[20]Aktet ligjore:VKM Nr.636,datë 20.09.2006"(Ref.nr.54.3);Urdheri i Ministrit te Arsimit,Sportit dhe Rinise,nr.528,date 04.09.2018(Ref.nr.54.4)

| | |
|---|---|
| të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropianë. | Organizimi, emërtimi, përmbajtja e programeve të studimit në departamentin e Arteve të Aplikuara në UET ishin në përputhje me legjislacionin në fuqi[21].<br>Struktura dhe lëndët që zhvillohen janë bazuar në VKM-në Nr.41 datë 24.1.2018 të ndara në: Lëndë bazë , Lëndë Karakterizuese, Lëndë ndërdisiplinore intëgruese, Lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse,<br><br>por...të gjitha këto lëndë kanë nëvojë për një ristrukturim të ri sepse "Profili" i diplomës nuk mund të qëndrojë në modulin C pasi është vlerë e modulit B dhe një pjesë e Lëndëve Karakterizuese të moduli B duhet të integrohen në një koncept ndryshe, pasi ky profil diplome do ti nxjerrë studentit probleme në tregun e punës. |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropianë. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të pakten një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje | Fusha e përgjithshme dhe specifike në programin e studimit Master i Arteve në "Arte Muzikore" me profile ishte në përputhje me fushën akademike të njësisë bazë, Departamenti i Arteve të Aplikuara.<br>Në Master programet ndërdisiplinore në Arte Muzikore nuk janë pjesë e strukturës mësimore. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi I.5**<br>**Institucioni i arsimit të larte siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznësit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të | Ndarja e detyrave dhe përgjegjësive në hartimin, mbikqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit ishin pasqyruar në rregulloren[22] dhe aktet e |

[21]Të dhëna tabelore për numrin e programeve te ofruara nga FSHHEAL dhe Departamentin e Arteve të Aplikuara (Ref.Nr.26).

[22]UET,neni 16-18,21-22(Ref.Nr.5);Dokumenti F.IV-F.V:Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit(Ref.Nr.6);Vendimin për emërimin e koordinatorëve të programeve të studimit(ref.Nr.36)

| | |
|---|---|
| frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | tjera nënligjore por pjesa më madhe mbulohej nga departamenti përgjegjës i këtij programi, në këtë rast departamenti i Arteve të Aplikuara. |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e proçesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznësit vendës dhe/ose të huaj. | Për realizimin e objektivave të proçesit mësimor në programin e studimit Master i Arteve në "Arte Muzikore" me profile institucioni[23] kishte vendosur bashkëpunime dhe marrëdhnje me institucione vendase, për realizimin e praktikave mësimore, si dhe bashkëpunime me aktorë të tregut të punës me qëllim punësimin e studentëve pas mbarimit të ciklit të studimeve.<br>Bashkëpunimi kishte gjetur fushë kryesisht me aktorët e biznesit vendas. |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institutë kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | UET demostron marrëveshje të nënshkruara me institucionet të tjerë të cilat i shërbejnë kryesisht qëllimit për realizimin e praktikave profesionale dhe ato të punës:<br>• Marrëveshje e lidhur ndërmjet Universitetit Europian të Tiranës dhe Universitetit të Arteve me Nr. 889 Prot. Datë, 17. 07. 2018.<br>• Marrëveshje e lidhur ndërmjet Universitetit Europian të Tiranës dhe Bashkisë Tiranë me Nr. 89 Prot. Datë, 01. 04. 2019.<br>• Marrëveshje e lidhur ndërmjet Universitetit Europian të Tiranes dhe Gazetës Liberale me Nr. 198 Prot. Datë, 17. 07. 2019.<br>• Marrëveshje e lidhur ndërmjet Universitetit Europian të Tiranës dhe Studios Muzikore *On off Production* me Nr. 196 Prot. Datë, 16. 07. 2019.<br>• Marrëveshje e lidhur ndërmjet Universitetit Europian të Tiranës dhe Shtëpisë Botuese UET PRESS me Nr. 197 Prot. Datë, 17. 07. 2019.<br>• Marrëveshje Nr. 317 Prot. Datë 28. 12. 2021, nënshkruar ndërmjet Universiteti Europian të Tiranës dhe Kompanisë Filmike A.A.<br>• Marrëveshje e lidhur ndërmjet Universitetit Europian të Tiranës dhe Organizatës Jofitimprurese *Harabel* me Nr. 117 Prot. Datë, 15. 04. 2022.<br>• Marreveshje e lidhur ndërmjet Universitetit Europian të Tiranës dhe Qendrës së Zhvillimit "Pëllumbat" Tiranë me Nr. 63 Prot. Datë, 17. 02. 2022. |
| **Kriteri 4.** Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të | Institucioni (UET) si dhe departamenti i Arteve të Aplikuara ka marrëveshje bashkëpunimi me istitucione[24] ku studentët kanë kryer praktikat mësimore ,marrëveshje të cilat janë pasqyruara në aktet e brëndeshme ku përshkruhen dhe proçedurat që janë ndjekur. |

[23] Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit (Ref.Nr.32);Marrveshjet e bashkëpunimit(Ref.Nr.34)
[24] Dokumenti B.I Mbi praktiken profesionale(Ref.Nr.32.1);B-1-4 Formulari i vetëvlerësimit të praktikës nga studenti(Ref.nr.32.2).

| | |
|---|---|
| natyrës specifike të programit të studimit që ofron. | |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institutë kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve. | UET demostron përfshirjen e tij në shumë projekte zhvilluese akademike në kuadrin e projekteve europiane të arsimit të lartë, projekte që targetohet stafi akademik, mobiliteti i pedagogëve dhe studentëve, aplikimin e standarteve të cilësisë europiane, organizimin e konferencave të përbashkëta dhe përkthime dhe botime akademike dhe pedagogjike nga autorë të njohur ndërkombëtar.<br>UET ka krijuar Zyrën e projekteve dhe Partneriteteve,me qëllim për të zhvilluar projekte ndërkombëtare,partneritete strategjike dhe të lehtësojë aplikimet për grante kërkimore,gjithashtu,nëpërmjet marrëveshjeve të krijuara është e mundur shkëmbimi i stafit,për të dhënë mësim, në universitete homologe dhe shkëmbimi i studenteve,nëpërmjet programit Erasmus+. |
| **Kriteri 6.** Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raportë analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit | Departamenti i Arteve të Aplikuara[25]kishte të inventarizuara një sërë raportesh analitike të përfitimeve nga këto marrveshje të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit Master i Arteve në "Arte Muzikore" me profile. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.6**<br>**Institucioni mbështët arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ndjek një politikë mbështëtëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve. | UET në eksperiencën disa vjeçare të fituar si ILA po synon të transformohet dhe në një institucion kërkimor ku ky produkt ti shërbejë tregut dhe ti shërbeje mësimdhënies…përsa i përket departamentit të Arteve të Aplikuara në "Arte Muzikore"është në fazë përpjekjesh për të konsoliduar pozicionet e tij ambicioze.<br>UET u ofron pedagogëve mundësinë për të publikuar në revistën ndërkombëtare shkencore POLIS dhe për të referuar në koferencën ndërkombëtare"Ditët e studimeve shqiptare"[26].<br>Janë rritur kërkesat në drejtim të cilësisë së punimeve duke kërkuar publikimeve në revista me faktorë impakti në Thomson Reuters/Clarivate. |

[25]Raporti analitik I përfitimeve nga marrëveshjet e bashkepunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve (Ref.nr.35)

[26]Strategjia e kërkimit ShkencorUET 2021-2025(Ref.Nr.3.3).

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. | UETdemostron se ka hartuar një strategji të kërkimit shkencor dhe e pasqyruar dhe në aktet rregullatore të tij është në përpjekje për ta shtrirë këtë objektiv dhe në Departamentin e Arteve të Aplikuara. |
| **Kriteri 3.** Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. | UET në aktet e tij rregullatore demostron se promovimin e rezultateve të kërkimit shkencor kanë një objektiv të prekshëm, por në rang Departamenti i Arteve të Aplikuara për "Arte Muzikore"janë në fazën e strukturimit të këtyre objektivave. |
| **Standardi III.2**<br>**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Për të pasur një transmetim dhe përvetësim sa më të mirë të njohurive, proçesi mësimor zhvillohej me leksione, me seminare, leksion/seminare, me detyra praktike dhe me detyra kursi, praktikat profesionale, punim diplome ose provim të përgjithshëm përfundimtar[64]. Kontrolli i dijeve ishte i vazhdueshëm në mënyrë që studentët të kishin mundësi të identifikojnë mangësitë dhe ti plotësojnë ato përpara përfundimit të semestrit. |
| **Kriteri 2.**Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitëtit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi altërnative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e | Të dhënat e përftuara nga vlerësimet periodike shërbenin jo vetëm për analizimin e situatës,por dhe për indentifikimin e problematikave me synim marrjen e masave për përmirësimin dhe garantimin e cilësisë së brendshme. Në bazë të fushës dhe natyrës së programit të studimit, të marrë nga studentët, personeli akademik përdorte forma të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies, përveç atyre klasike si referimit |

[60]Formati I vleresimit te pedagogut nga studentet(Ref.nr.40)
[61]Dokumenti F.VII Mbi funksionimin e zyres se Keshillimit te Karrieres dhe Kujdesit ndaj studentit(Ref.nr.12)
[62]Dokumentacioni mbi sigurimin e brendshem i cilesise (Ref.nr.30-30.8)
[63]Dokumentacioni mbi sigurimin e brendshem i cilesise (Ref.nr.30-30.8)
[64]Dokumenti A.III.Mbi parimet e ndertimit te programit te lendes, pika A.III.3 (Ref.nr.39).

| | |
|---|---|
| studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij. | me gojë të studentëve, detyra të shkurtra me shkrim (ese), projekte studimi në grup, mjete audio-vizive etj. |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështetpersonelin e tij akademik në përmirësimin e kompetëncave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. | Një drejtim i rëndësishëm për sigurimin e cilësisë në UET, lidhej me trajnimin e pedagogëve. Institucioni siguronte një program trajnimi të strukturuar për stafin akademik në përputhje me gradën shkencore. Universiteti demostron se organizon në mënyrë periodike Staff Development Day - Ditën e Zhvillimit të Stafit, me synimin trajnimin e stafit në fusha të lidhura me mësimdhënien dhe me metodologjinë. Gjithashtu, personeli akademik kishte mundësi të përfitonte nga programet e shkëmbimit të stafit me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencat dhe njohuritë me praktikat e mira ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes. |
| **Kriteri 4.**Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tëmatikave dhe profilit. | Personeli akademik ishte i formuar në mënyrë të përshtatshme për kurset që zhvillon dhe ishte kompetent për shpjegimin e koncepteve dhe përforcimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit, përveç kualifikimit të përshtatshëm kishin edhe eksperiencë akademike dhe profesionale në këtë fushë. Personeli akademik gjatë leksioneve/seminareve përdorte metoda të ndryshme të mësimdhënies, ku në varësi të tematikës, përdorte metoda tradicionale ose bashkëkohore të mësimdhënies. Këto metoda ndërthureshin duke pasur herë në qendër studentin e herë pedagogun[65]. |
| **Kriteri 5.** Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proçes dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | Institucioni demonstroi se i kushtonte vëmëndje të veçantë mendimit dhe kërkesave të studentëve me të cilët zhvilloheshin në mënyrë periodike fokus-grupe për të marrë informacion në lidhje me aspektet që kishin nevojë të përmirësoheshin në lidhje me mësimdhënien. Departamenti organizonte një herë në muaj mbledhje të hapur për studentët e programeve që administron duke dëgjuar sugjerimet dhe problematikat e tyre në lidhje me proçesin mësimor. Autoritetet drejtuese dhe përgjegjësi i departamentit pasi bënin verifikimet e nevojshme merrnin masa konkrete me qëllim përmirësimin e situatës, masat mund të lidhen me ndryshime në programin e një lënde të caktuar, me ndryshime të kurikulës së programit ose me ndryshim të personelit akademik që zhvillon lëndën, në rastin kur konstatohet se pedagogu nuk ka kompetencën për të vijuar angazhimin. |
| **Kriteri 6.**Personeli akademik përdor metoda intëraktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit. | Metodat interaktive dhe diskutimi ishin pjesë e zakonshme e orëve të mësimit, mënyra e konceptimit dhe e zhvillimit të mësimit, garantonte angazhimin e vazhdueshëm të studentëve. Zhvillimi i orëve interaktive, të cilat ndërthurin shpjegimet teorike-aplikative duke u fokusuar tek ndërveprimi i vazhdueshëm pedagog-student i cili garantonte zhvillimin intensiv të proçesit të angazhimit të studentëve. |

[65]Dokumenti A.III.Mbi parimet e ndertimit te programit te lendes, pika A.III.3 (Ref.nr.39).

| Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre | Stafi akademik nxiste në mënyrë të vazhdueshme autonominë dhe mendimin kritik të studentëve. Nëpërmjet literaturës së rekomanduar për të studiuar në mënyrë të pavaruar nxitej zgjerimi i konsiderueshëm i të nxënit jashtë auditorit. Pedagogët nxisnin realizimin e detyrave nga ana e studentëve, gjatë orëve të seminarit, si një mënyrë për të nxitur punën e pavaruar dhe përfshirjen më të madhe të tyre në proçesin e mësimdhënies[66]. | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.3**<br>**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Proçesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. | "Hapësirat në të cilat zhvillohet proçesi mësimor janë të përshtatshme dhe cilësore, duke ju përgjigjur specifikave të programeve në fushën e arteve.UET ka në dispozicion dy godina, sipërfaqe totale e të cilave është rreth 7545m2. Sipërfaqet e shfrytëzueshme janë të ndara në salla leksionesh, gjithsej 15 salla me sipërfaqe totale 1447m2 dhe 1138 vende.Salla seminari janë gjithsej 13, me sipërfaqe 561m2 dhe 353 vende[67]". |
| **Kriteri 2.** Ambientët e dedikuara për proçesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të proçesit mësimor, por edhe praktikave. | "UET ka aktualisht në përdorim 33 salla mësimore,(leksione dhe seminare)nga këto 4 salla të dedikuara posaçërisht për artet,të gjitha të pajisura me mjete audiovizive si PC,projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit. Biblioteka njëkohësisht është e pajisur me PC në mënyrë që studentët të kenë mundësi për të aksesuar në biblotekat online. Kompjuterat janë të gjithë me sistemin e instaluar Windows 10. Në pajisjet kompjuterike është instaluar e gjithë paketa e Microsoft Office 365 e plotë me të gjithë software-ët e saj: Access, Communcator, Exel, InfoPat, OnëNotë, OnëDrive, Outlook, PowerPoint, Publisher, SharePoint, Workspace, Word. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjete didaktike të nevojshme për zhvillimin modern të proçesit mësimor. Gjithashtu tek këto laboratorë janë të instaluar edhe programe grafike, audio dhe video, si programet e paketës Adobe Creative Cloud, ku ndër këto: Acrobat, Photoshop, Ilustator, InDesign, PremierePro, AferEffects, Audition, MediaEncoder, DreamWaver, AdobeXD etj. Apo programet e modelimit 3D si Audodesk3dsMax, AutodeskMaya, AutodeskVREDDesign, Blender," etj. |
| **Kriteri 3.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar | "Hapësirat në të cilat zhvillohet proçesi mësimor janë të përshtatshme dhe cilësore, duke ju përgjigjur specifikave të programeve në fushën e arteve.UET ka në dispozicion dy godina, |

[66] Syllabuset e lendeve (Ref.Nr.19);CV e stafitakademik (Ref.nr.20)
[67] Infrastruktura ne funksionte programeve te studimit (Ref.nr.42).

| | |
|---|---|
| IT të nevojshme për realizimin e proçesin mësimor. | sipërfaqe totale e të cilave është rreth 7545m2. Sipërfaqet e shfrytëzueshme janë të ndara në salla leksionesh, gjithsej 15 salla me sipërfaqe totale 1447m2 dhe 1138 vende.Salla seminari janë gjithsej 13, me sipërfaqe 561m2, dhe 353 vende[68]". |
| **Kriteri 4.**Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit. | "Mirëmbatja dhe azhornimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i zyrës dhe i teknologjisë së informacionit. Instalimet e programeve dhe azhornimet e tyre bëhen në kohë reale. Në të njëjtën kohë programet kompjuterike u janë përshtatur programeve mësimore duke instaluar programet aplikative që kërkohen nga departamenti përkatës.<br>Të gjitha klasat janë të pajisura me internet duke ndjekur zhvillimet e reja teknologjike UET-i ka investuar në sisteme mbështësin studentin në proçesin mësimor. Me konkretisht në sistemin MOODLE (UET LMS), ky sistem bën të mundur që studenti në kohë reale të azhornohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtësë audiovizive,"etj. |
| **Kriteri 5.** Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë proçesit mësimor. | "Literatura bazë dhe e rekomanduar në fushën e arteve konsiderohet e përshtatshme në funksion të realizimit të objektivave muzikore. Në çdo syllabus të hartuar vendoset literaturë bazë dhe ndihmëse, të cilat i lejojnë studentëve marrjen e njohurive të nevojshme të parashikuar në programin e studimit. Ato u vendosen studentëve në dispozicion, në mënyrë fizike ose elektronike (në sistemin LMS) nga pedagogu i lëndës. Biblioteka është abonuar për një periudhë 5-vjeçare në libraritë elektronike Sage&Ebsco si dhe Questia. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online)". Në bibliotekën universitare të Universitetit Europian të Tiranës janë gjithesej 6425, tituj të regjistruar dhe që ndodhen fizikisht në bibliotekë, gjithashtu janë në proces regjistrimi dhe përpunimi të të dhënave bibliotekare, librat e dhuruara nga Al Dent ku janë mbi 2000 libra në gjuhë të huaj dhe në gjuhën shqipe.<br><br>Perveç librave që ndodhen fizikisht në bibliotekën universitare të UET, bazuar në marrëveshjet e nënshkruara me operatorët ndërkombëtarë, për studentët dhe pedagogët funksionojnë platformat online në të cilat jemi abonuar me ato të quajtura COBISS si edhe me SAGE dhe EBSCO.<br><br>Gjithashtu në sallën e bibliotekës ndodhen 20 banka 40 karrige dhe 6 kompjutera të lidhur me internet në shërbim të studentëve dhe pedagogëve.<br><br>Me anë të pltaformave online, një praktike e njohur tashmë në nivel ndërkombëtar, studenti dhe pedagogu në UET, akseson libra dhe literaturë muzikore nga një rrjet tepër i madh bibliotekash në mbarë botën, duke hulumtuar jo vetëm në fondin arkivor të tyre, |

68 Te dhena mbi platformen Learning Menagement System(Ref.nr.46)

| | |
|---|---|
| | por edhe në literaturën e përditësuar së fundmi nga ky rrjet i gjerë bibliotekash. |
| **Kriteri 6.** Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë online të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. | "Biblioteka e UET është tepër e pasur dhe ka një numër të madh librash të botimeve të fundit të cilët i përkasin drejtimeve të programeve të studimit. Biblioteka e UET furnizohet vazhdimisht me botime periodike. Institucioni mbështet gjetjen e burimeve online të kërkuar nga pedagogët dhe studentët. Biblioteka ka gjithsej 150 vende leximi, 12 kompjutëra dhe gjithë ambienti është i mbuluar nga rrejti Wireless. Biblioteka ka krijuar një katalog me libra elektronikë në gjuhë të huaj, i cili ka qindra tituj librash në bazë të programit të studimit dhe që u vjen në ndihmë studentëve të të gjitha niveleve të studimit. Studentët kanë mundësi të aksesojnë bibliotekën edhe online". |
| **Kriteri 7.** Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave te kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. | "Biblioteka mundëson aksesin në libraritë online si për personelin akademik, ashtu edhe për studentët. Stafi i bibliotekës afron mbështetje në gjetjen e burimeve online të kërkuara. Biblioteka është e pajisur me PC, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë bibliotekat online të vëna në dispozicion nga UET. Gjithashtu biblioteka ka siguruar akses në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj e libra shkencorë si: Questia, Social, Science, Library, Sage. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online)". |
| **Kriteri 8.** Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma online (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre. | "UET disponon infrastruktuën e nevojshme për realizimin e objektivave mësimorë. Çdo sallë është e pajisur me PC dhe projektor të cilat shtrytëzohen nga studentët për realizimin e diplomave apo detyrave të kursit[69]. Studenti mund të punojë në bibliotekë ose në sallën e internetit për detyrat e kursit apo për punimin e diplomës që duhet të shkruajë. Gjithashtu specifikisht për programet e arteve, infrastruktura laboratorike e nevojshme vlerësohet si e plotë dhe e përshtatshme". |
| **Kriteri 9.**Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar. | Nga vëzhgimi në laboratorë dallohej kujdesi për të ndjekur zhvillimet e reja teknologjike, UET investon në sisteme, të cilët e mbështesin studentin në proçesin mësimor. Më konkretisht në sistemin MOODLE (UET LMS[70]), ky sistem bën të mundur që studenti në kohë reale të azhornohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë, audio-vizive etj. Ka mundësi të komunikojë nëpërmjet sistemit në forume të hapura me |

[69] Te dhena mbi platformen Learning Menagement System(Ref.nr.46)

[70] Vendim mbi zhvillimin e procesit akademik ne situaten e krijuar nga pandemia Covid-19(Ref.nr.5.1)

| | |
|---|---|
| | pedagogët si dhe kolegët e kursit që ndjek, të shikojë notat dhe pikët online nga kudo që ndodhet. Gjithashtu edhe personeli akademik përdor rregullisht e-learning dhe, si ata ashtu edhe studentët, nxitën për të përdorur sa më shumë. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik i UET përdor platformën online UET LMS[71]dhe Microsoft Teams. Çdo pedagog në UET komunikon me studentët e tij nëpërmjet UET LMS[72]. Nëpërmjet këtij sistemi, pedagogu bën njoftime, ngarkon sylabus-in, prezantimet, leksionet, u jep linke me materiale shtësë, hedh pikët e vlerësimit për studentët e tij", etj. |
| **Kriteri 10.**Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e tëmave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre | Nga UET LMS demonstrohet që pedagogët dhe studentët shkëmbejnë materiale, njoftime dhe çdo informacion që lidhet me lëndën. Studenti ka akses në materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio-vizive" etj.<br>I gjithë proçesi nga aplikimi deri tek dorëzimi i punimit te diplomës është i rregulluar në mënyrë të detajuar me dokumentin B.II,pjesë e Broshurës së dokumentave[73]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.4**<br>**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. | Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) funksionon si një strukturë autonome e përhershme në strukturën organizative të universitetit. Ai vlerëson, periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore, si dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën evropianë të arismit të lartë dhe legjilacionit në fuqi[74]. Kjo zyrë bashkëpunon me njësitë kryesore dhe bazë dhe realizon një sërë aktivitetesh të parashikuara në planin e saj të veprimit, në funksion të monitorimit dhe përmirësismit të cilësisë së mësimdhënies[75]. |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes tëpersoneli akademik dhe studentët | Departamenti funksionon si përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programet e studimit që ofron. Ai përzgjedh personelin akademik që angazhohet në mësimdhënie, si dhe garanton shpërndarjen e ngarkesave |

[71] Video-trajnime mbi sisteminTEAMS/LMS;Raport:ecuriae mesimitonline(Ref.nr.46.4,46.5)
[72] Video-trajnime mbi sisteminTEAMS/LMS;Raport:ecuriae mesimitonline(Ref.nr.46.4,46.5)
[73] Dokumenti B.II,Mbi pranimin e dipolimes(Ref.nr10)
[74] Statuti i UET,neni 16(Ref.nr.2)
[75] Plani I veprimit;KSBC(Ref.nr30.1)

| | |
|---|---|
| për cilësinë në programin e studimit që ofron. | mësimore në përputhje me parimet dhe kriteret e vendosura për të garantuar që mësimi të zhvillohet nga personeli me ekspertizën dhe kualifikimin e nevojshëm. Departamenti miraton syllabus-et e hartuara, bën vlerësimin e mësimdhënies, qoftë duke ndjekur zhvillimin e orëve të mësimit nga personeli akademik qoftë duke i inkurajuar studentët të raportojnë për problemet që mund të jenë evidentuar në mbledhjet e hapuara me ta, por jo vetëm. Stafi dhe studentët e dinë që do i nënshtrohen një proçesi të vlerësimit të mësimdhënies, gjë e cila rrit vetëdijen dhe cilësinë e mësimdhënies[76]. |
| **Kriteri 3.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështësin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. | "Eksperimentimi dhe zhvillimi i metodave të reja të mësimdhënies inkurajohet dhe në kuadrin e departamentit por dhe prej dekanatit dhe rektoratit. Personelit akademik i kërkohet "të shfrytëzoje maksimalisht metodat e reja inovative në proçesin e mësimdhënies. Në formatin e hartimittë syllabus-eve, personelit akademik i kërkohet të evidentojnë për çdo temë metodat pedagogjike që do të përdoren në mësimdhënie"[77]. |
| **Kriteri 4.**Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtëjshëm të mësimdhënies. | "Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në përputhje me vizionin e UET sepse kërkimi shkencor është në funksion të rritjes cilësore të mësimdhënies dhe mësimnxënies, nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafit akademik, trasnferimit të arritjeve bashkëkohore në fushën e shkencës tek studentët si dhe përfshirjes së këtyre të fundit në veprimtari kërkimore. Në bashkëpunim me Qendrën e Metodologjisë dhe Kërkimit ofrohen trajnime 1-ditore ose më gjatë për të rritur aftësitë e stafit akademik, për të ndërmarrë punë kërkimore të pavarur që të jetë e botueshme në revista shkencore me faktorë impakti. Trajnimet ndahen në katër grupe:<br>1. Trajnime për doktorantë<br>2. Trajnime për junior researches<br>3. Trajnime për senior researches<br>4. Trajnime metodologjike[78]<br>Kjo është një ndër pikat që UET e ka në vëmëndje të vazhdueshme dhe kujdeset që ta kthejë këtë përpjekje në një pikë të fortë". |
| **Kriteri 5.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. | Trajnimet e personelit akademik për çështje didaktike dhe të metodave kanë qenë sistematike. Personeli akademik i UET ka mundësi të përmirësoje aftësitë e tij në mësimdhënie duke shfrytëzuar edhe përdorimin e metodave të reja përmes:<br>A. Periudhave të shkëmbimit të eksperiencës në universitete partnere, në kuadër të programit Erasmus+KAI |

[76] Dokumenti F.V,Per organizimin dhe funksionimin e dekanatitdhe departamentit(Ref.nr.6)
[77] Formati per hartimin e syllabusit(Ref.nr.3.2)
[78] Strategjia e kerkimit shkencor ne UET 2017-2020(Ref.nr.3.2); Strategjia e kerkimit shkencor ne UET 2021-2025,pikat 1,2,3,4,6, dhe 12(Ref.nr.3.2);

| | |
|---|---|
| | **B.** Trajnimeve të herëpashershme nga lektorë të ftuar apo anëtarë të personelit të UET (zyra e IT, apo njësi të tjera[79]). |
| **Kriteri 6.**Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. | Personeli akademik është përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe përmirësimin e mësimdhënies që fillon që në momentin e hartimit të syllabus-it të lëndës, duke përfshire metodat e mësimdhënies për secilën temë. Pavarësisht përpjekjeve të institucionit për të promovuar përdorimin e këtyre metodave përsëri vihet re se përvetësimi dhe shfrytëzimi i tyre në mësimdhënie përqafohet më kollaj nga brezi i pedagogëve të rinj ndërkohë që përdoren më pak nga brezi i atyre më me shumë përvojë. |
| **Kriteri 7.**Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik tëstojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektët e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. | Personeli akademik ka lirinë të testojë metoda të reja në mësimdhënie, dhe duke qenë se syllabus-et e lëndëve shikohen çdo vit, ka mundësi të reflektojë përshtatjet dhe ndryshimet e nevojshme, në përputhje me rezultatet e përdorimit të tyre në përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies tek studentët. |
| **Kriteri 8.** Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnërëve në proçesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor | Në kuadër të proçesit të ndërkombëtarizimit, UET mund të angazhojë në proçesin mësimor lektorë të huaj nga universitete partnere ose nga universitete të tjera analoge.Angazhimi i lektorëve të huaj të cilët janë profesionistë të fushës, shihet si element i rëndësishëm për pasurimin e proçesit të mësimdhënies dhe lidhjen me tregun e punës. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | UET demonstron se ka rregullore të posaçme për kriteret dhe mënyrën e testimit dhe vlerësimit të njohurive, e cila bëhet publike për studentët. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregulloren e programit të studimit, pika 5 "Kontrolli dhe vlerësimi i dijeve", si edhe me dokument të veçantë, pjesë e Broshurës së Dokumentëve[80]. Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive u njoftohen studentëve gjatë javës së orientimit (për studentët e rinj), por edhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse. Gjithashtu, studenti mund të përfitojë nga shërbimi i kujdesit dhe |

[79] Plani strategjik per zhvillimin e programit,Prioritet ne trajnimin e vazhdueshem te stafit akademik;Video-trajnime mbi sisteminTeams/LMS(Ref.nr.3.2)

[80] Rregullore e programit te studimit(Ref.Nr.7)Dokumenti A.IV.Persistemin e vleresimitte studenteve(Ref.nr.7.1)

| | |
|---|---|
| | këshillimit të vazhdueshëm që ofrohet nga Koordinatorja e departamentit dhe Zyra e Kujdesit ndaj Studentit. |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët, njiheshin me përmbajtjen e syllabusit dhe formën e vlerësimit, të prezantuar nga pedagogu i lëndës. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetëj në parimin e kotrollit të vazhdueshëm dhe në çdo sylabus është seksioni "Kontrolli i Vazhdueshëm"[81], ku në bazë të tipologjisë së lëndës, përcaktohej dhe vlerësimi i studentëve. Njoftime të detajuara për detyrat dhe provimet në kuadër të lëndës vendosen edhe në platformën LMS, si dhe u njoftoheshin me e-mail nga koordinatorja e departamentit. |
| **Kriteri 3.**Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara | Vlerësimi i studentit bëhej në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim të trefishtë.<br>a) Nxiste studentin që të mësojë gjatë gjithë vitit;<br>b) Prodhonte një vlerësim objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim;<br>c) Shërbente për të vlerësuar ecurinë e kursit gjatë semestrit nëse studentët janë duke e kuptuar matërialin që po ofrohet në kurs.<br>Testimi dhe vlerësimi i njohurive të studentëve ishte i ndarë në disa komponentë. Në rregulloren e programit të studimit parashikoheshin larmishmëri formash së kryerjes së detyrave në varësi të tipologjisë së lëndës, me qëllim që pedagogu të mund të zgjedhë atë që i përshtatët më mirë natyrës së lëndës dhe evidenton më mirë rezultatet e synuara të të nxënit[82]. Kjo formë vlerësimi e ndarë në disa komponentë, nxiste studentët që të mësojnë në mënyrë të vazhdueshme. Gjithashtu është një tregues për të kuptuar nëse studentët po e kuptojnë materialin që po u ofrohet dhe nëse objektivat mësimor po arrihen. |

| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.6**<br>**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.**Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. | Sipas dokumentave të vendosura në dispozicion, vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetëj në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, gjatë gjithë semestrit. Gjatë gjithë vitit akademik kryhen testime dhe vlerësime të njohurive, dijeve dhe aftësive të cilat reflektohen në vlerësimin përfundimtar. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetej në parimin e kontrollit të vazhdueshëm gjatë gjithë semestrit. |

[81] Syllabuset e lendeve (Ref.Nr.19).

[82] Dokumenti A.IV,Per SISTEMIN E VLERESIMITTE STUDENTEVE(Ref.nr.7.1)

| | |
|---|---|
| | Nota përfundimtare ishte rezultante e kombinimit të elementëve të mëposhtme:<br>a) Provimi i ndërmjetëm<br>b) Niveli i diskutimit në seminare<br>c) Detyra e kursit (ese, prezantime, projekte)/dy detyra praktike<br>d) Provimi përfundimtar[83]<br>Nota përfundimtare ishte rezultante e kombinimit të disa elementëve, në varësi të tipologjisë së lëndës[84]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Sistemet elektronike të testimit dhe vlerësimit përdoreshin në të gjitha ato raste kur ka qenë e mundur kjo gjë, pra sipas karakterit të lëndës. Institucioni në bashkëpunim me AADF (Albanian-American Development Foundation) po promovon një sistem të ri vlerësimi elektronik "clean scoring". Ky sistem ishte aplikuar në lëndë të ndryshme si në nivelin bachelor dhe master. |
| **Kriteri 3.**Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionët e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit. | "Vlerësimi me komision ishte i detyrueshëm vetëm për detyrimin si praktika profesionale dhe punimi i diplomës/provimi i përgjithshëm përfundimtar. Në rastin e lëndëve të programit, ishte në gjykimin e titullarit nëse korigjimin do e bëjë i vetëm, apo në bashkëpunim me pedagogët asistentë[85]. Në rast se studenti kishte ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit, (provim i ndërmjetën, detyrë kursi, provim përfundimtar), pasi kishte konsumuar proçedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës, ai mund t'i drejtojë përgjegjësit të departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Përgjegjësi i Departamentit ngre një komision me 3 anëtarë, i cili bën shqyrtimin e kërkesës dhe merr vendim me shumicë të thjeshtë[86]. |
| **Kriteri 4.**Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me përsonël dhe/ose kamera sigurie. | Provimet e studentëve sekretoheshin dhe UET kishte siguruar gjithmonë infrastrukturën e nevojshme për këtë gjë, duke i pajisur sallat e provimeve me përsonel të posaçëm monitorues. Provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare zhvilloheshin me proçedurë sekretimi duke i mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzonte provimet e korrigjuara në sekretarinë mësimore[87]. Çdo provim monitorohej nga dy pedagogë, sipas grafikut të miratuar nga përgjegjësi i departamentit[88]. |
| **Kriteri 5.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback | Vlerësimi i detyrave të kursit shoqërohej me komente për t'i evidentuar studentëve pikat e tyre të dobëta dhe mënyrën sesi ato mund të përmirësoheshin. Në fund të pyetjeve të çdo eseje ishte një seksion i |

[83] Rregullore UET,Neni 24(Ref.nr.5)
[84] Rregullore mesimore e programit te studimit(Ref.Nr.7) Rregullore UET,Neni 27 pika 4(Ref.nr.5)
[85] Rregullore mesimore e programit te studimit pika 5.8(Ref.Nr.7)
[86] Rregullore mesimore e programit te studimit pika 5.8(Ref.Nr.7)
[87] Rregullore e programit te studimit(Ref.Nr.7)Dokumenti mbi funksionimin e SekretariseMesimore,pika E.1.8.6(Ref.nr9)
[88] Dokumenti A.IV,Per SISTEMIN E VLERESIMITTE STUDENTEVE(Ref.nr.7.2)pikaA.IV.2.6(Ref.nr7.1)

| | |
|---|---|
| (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi proçesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | emërtuar "vlerësimi i pedagogut" ku pedagogu jepte mendim mbi esenë e studentit. Në tezat e provimeve ishte seksioni "komente të pedagogut rreth përgjigjes së studentit për pytjen e kategorisë C "Mbaj qëndrimin tënd" ku pedagogu jep opinion mbi zhvillimin e pyetjes nga studenti. Në funksion të sqarimit të studentit ishin edhe seancat sqaruese, ku ata mund të shohin në detaje korrigjimin e pedagogut dhe të marrin drejtpërdrejtë nga ai/ajo komente të detajuara mbi vlerësimin e tyre[89]. |
| **Kriteri 6.** Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | "Gjatë zhvillimi të provimeve, provimi/salla ku zhvillohej testimi monitorohej nga dy ose më shumë pedagogë të caktuar me miratim nga Departamenti, të cilat ishin njëlloj përgjegjës për ecurinë e provimit në sallë. Studentët lënë në një vend të veçantë çantat, librat, leksionet dhe çdo material tjetër mësimor e informativ që ka lidhje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me lëndën e provimit. Telefonat celulare duhet të jenë të fikur dhe nuk lejohet përdorimi i tyre për asnjë lloj qëllimi[90]. Plagjiatura dhe kopjimi ndërshkohet me marrjen e notës 4(katër) si notë përfundimtare, pavarësisht vlerës së elementëve të tjera vlerësuese[91]. Gjithashtu, UET që prej vitit 2015, implementon sistemin antiplagjiaturë *(Turnitin Ephorus),* në mënyrë që punimet e studentëve të mund të kalojnë një kontroll elektronik cilësor, të shpejtë dhe efikas, për plagjiaturë përpara se të marrin vlerësimin final nga pedagogët, apo komisionët e vlerësimit përkatës". |
| **Kriteri 7.**Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazoheshin mbi meritën e studentëve. Vlerësimi i studentit me pikë shënohej në fletën e provimit, e cila firmosej nga pedagogu që kishte hartuar tëzën dhe formatin përmbledhës të vlerësimit të studentëve. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhej brenda 2(dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre. Në rastin e riprovimeve, duke qenë se numri i studentëve pjesëmarrës ishte më i ulët se në sezonët normale, afati për dorëzimin e korrigjimeve ishte 1(një) javë[92]. Vlerësimi për komponentët e tjerë që duhej të dorëzoheshin përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, pedagogu nuk kishte të drejtë të ndërhynte për ndryshimin e tyre pas zbardhjes së rezultateve të provimeve. |
| **Kriteri 8.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin dhe kërkesa për rishikimi të tij janë të garantuara në UET. Studenti informohej në kohë reale për rezultatet e vlerësimit, përmes sistemit online (LMS dhe UMIS). Brenda dy javëve nga realizimi i provimit, në orarin e caktuar për tutoriat dhe/ose këshillimit akademik, pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me |

[89] Formati I tezes se provimitperfundimtar(Ref.nr.7.2)
[90] Dokumenti A.IV,Per sistemin e vleresimit te studenteve(Ref.nr.7.2) pikaA.IV.2.6(Ref.nr7.1)
[91] Rregullore UET,Neni 33,(Ref.nr.5)
[92] Rregullore UET,Neni 27,(Ref.nr.5)

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | velrësimin[93]. Pas këtij afati, pedagogu plotëson dhe dorëzon proçesverbalin përfundimtar në Sekretarinë Mësimore. | | | |
| **Kriteri 9.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparentë për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet | Kërkesat dhe ankimimet shqyrtoheshin nga një komision vlerësimi që ngrihej në departament, duke përfshirë pedagogë kompetentë për të gjykuar çështjen, pasi fusha e tyre e ekspertizës konsiderohet e njëjtë ose e afërt me atë që ishte subjekt vlerësimi. Proçedura zhvillohej në mënyrë transparente, dokumentohej dhe arkivohej. Pas seancave sqaruese, nëse studenti mbetej i bindur se vlerësimi nga ana e pedagogut nuk është korrekt, atëherë mund t'i drejtohej Departamentit me kërkesë për rivlerësim[94]. Vlerësimi i Komisionit që ngrihej ishte përfundimtar dhe mund të ishte i njëjtë, më i larte ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar. Proçesverbalet e vlerësimit firmoseshin dhe dorëzoheshin në Sekretarinë Mësimore, dhe arkivoheshin në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.7**<br>**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetëncave profesionale e shkencore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Programi i studimit synon ta pajisë studentin me njohuri dhe koncepte bazë të disiplinave artistike, si në lëndët karakterizuese ashtu edhe në ato të profileve specifike. Ky program nëpërmjet njohurive teorike, shërben në zhvillimin e aftësisë të studentëve për të qenë të aftë për t'u përfshirë në tregun e punës[95]. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humanë sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Përveç lëndëve të fushës së arteve, në programin e studimit bënin pjesë edhe lëndë nga fusha të tjera, të cilat ndihmonin në zhvillimin e aftësive të studentëve në fushën e IT, humane sociale, komunikimit, gjuhët e huaja, shkrimin akademik dhe metodat e kërkimit. |
| **Kriteri 3.**Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. | Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizoheshin e shqyrtoheshin në përfundim të lëndës. Si rregull, pedagogët përpara përfundimit të lëndës bënin një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara, duke përfshirë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë |

[93] Rregullore e programit te studimit,(Ref.nr.7)

[94] Rregullore e programit te studimit,pika 5.8(Ref.nr.7)

[95] Rregullore e programit,AneksiI(Ref.N.7





| | |
|---|---|
| | mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohej në vijim. Një mënyrë për të shqyrtuar se çfarë studentët kishin kuptuar përpara se të mbyllin kursin, ishin esetë dhe detyrat e kursit që realizoheshin në javën e 13-të. |
| **Kriteri 4.** Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe tëstin përfundimtar. | Studentët orientoheshin para testimeve të pjesshme dhe përfundimtare, në mënyrë që të fokusoheshin të çështjet më të rëndësishme të lëndës. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik nxirrtë në pah çështjet më të rëndësishme të cilat do t'u nevojiteshin studentëve. Pedagogu mund të ndalej më gjatë në elementët që kishin rezultuar më të vështirë për t'u përvetësuar nga studentët, gjatë semestrit. Gjithashtu pedagogu ishte në dispozicion të studentëve për konsulta përpara provimit dhe gjatë orëve të takimit zyrtar, sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit. |
| **Kriteri 5.**Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. | Në UET zhvillohen vazhdimisht leksione të hapura, nga pedagogë të UET ose ekspertë e personalitete të ftuar, për çështje të aktualitetit dhe zhvillimeve të reja në fushën e shkencës dhe teknologjisë. Këto leksione zhvillohen si në kuadër të lëndëve të caktuara të programit të studimit, ashtu edhe si aktivitete ekstrakurrikulare, dhe janë të hapura për t'u ndjekur nga të gjithë studentët e interesuar dhe personeli akademik[96]. |
| **Kriteri 6.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. | I gjithë proçesi i mësimdhënies ishte i orientuar mbi bazë kompetencash, në nivel programi dhe lëndësh specifike, me qëllim dhënien mundësi studentëve të zhvillojnë njohuritë e përfituara në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke gërshetuar kompetencat teorike me ato praktike dhe profesionale. |
| **Kriteri 7.**Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në intërpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara. | Personeli akademik, nxiste bashkëpunimin ndërmjet studentëve dhe punën në grup të tyre. Gjatë orëve të seminarit, pedagogët mund të jepnin raste studimore, për intërpretimin dhe zgjidhjen e të cilave angazhonin studentë në punë në grup. Gjithashtu për detyrat e kursit që studentët mund të prezantonin gjatë orëve të seminarit, pedagogët lejojnin që studentët ta zhvillojnë atë me grupe prej 2-3 vetash, në bazë të temave të përcaktuara më parë. Në këtë mënyrë zhvillohen edhe aftësitë e studentëve për të punuar në grup. |
| **Kriteri 8.**Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet. | Personeli akademik ishte i informuar për strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe strategjinë kërkimore shkencore, përmes një dokumentacioni të gjerë rregullator që ishte i publikuar në internet, në një folder ku i gjithë personeli kishte akses. Ai nxitej edhe përmes stimujsh financiare që të bëhej pjesë e projekteve, të publikohej me kolegët në kuadër të grupeve kërkimore të organizuara në nivel bazë, kryesore dhe institucioni. Gjithashtu personeli akademik i kërkohej të inkurajonte edhe përfshirjen e studentëve, në punën kërkimore shkencore. Stafi akademik inkurajohej të kryente studime që lidhen me lëndët që zhvilloheshin, dhe t'i përfshijë publikimet në literaturën |

96 Kalendari i aktivitetve(Ref.Nr.55,1)

| | |
|---|---|
| | e syllabusit të lëndës, për t'i trajtuar gjetjet edhe me studentët gjatë orëve të seminarit. |
| **Kriteri 9.** Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | Institucioni nxiste zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. Sipas "Strategjisë Kërkimore Shkencore"kjo ishte pjesë e strategjisë makro të UET, por në lidhje me departamentin e Arteve të Aplikuara në "Arte muzikore" duke qenë se janë në fillimet e saj puna kerkimore-shkencore[97] do të duhet të kapte kohën dhe kushtet e saj në të ardhmen. |
| **Kriteri 10.**Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve | Personeli akademik ndërthurte format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. Shkëmbimet e personelit akademik me unverisitetet partnere perëndimore, në kuadër të projekteve Erasmus + KA1, mundësonin rritjen e shkëmbimit të eksperiencës dhe përfitimit prej praktikave më të mira, të cilat adaptohen nga personeli akademik pas rikthimit në UET, dhe mund të përhapen edhe tek kolegët e tjerë në institucion. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.8**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. | UET nga dokumentacioni dhe faktet reale që grupi i ekspertëve vuri re, se ai hartonte rregullisht një procedurë të posaçme për studentët të cilët japin provimin final ose mbrojnë diplomën[98]. Mbrojtja e Diplomës mund të kryhej përmes:<br>• Paraqitjes së një punimi diplome, i cili mund të ishte (i) *temë diplome* , për programet Master, me kërkesë të studentit, për studentët me notë mesatare së paku 8.5 (tëtë presje pesë);<br>• Dhënies së një provimi të përgjithshëm përfundimtar (PPP)<br>Dokumenti B.II për punimin e diplomës, jepte në mënyrë të detajuar çdo proçedurë që ndiqej nga aplikimi dhe miratimi i temës së diplomës, tek proçesi i udhëheqjes së saj përmes seancave metodologjike, deri tek |

[97] Strategjia e kerkimit shkencor ne UET 2017-2020(Ref.nr.3.1); Strategjia e kerkimit shkencor ne UET 2021-2025,(Ref.nr.3.2);
[98] Dokumenti B.II Mbi punimin e Diplomes, (Ref,nr.10)

| | |
|---|---|
| | formati i dorëzimit dhe mbrojtja përpara komisionit[99]. Ky informacion i vihej në dispozicion studentit përpara aplikimit për punim diplome. |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacionë, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. | Përmbajtja e programit të Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar bazohej në disiplinat kryesore të programit të studimit të ciklit të dytë. Lista e pyetjeve hartohej nga Departamenti dhe shpallej për studentët brenda datës 31 Mars të çdo viti akademik.[100] Studentët zgjedhinin temë diplome, zhvillonin seanca metodologjike me udhëheqësit e tyre, që i orientonin gjatë punimit të saj. |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy vitëve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Për realizimin dhe përmbajtjen e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar, institucioni kishte hartuar, proçedurë të posaçme për të. Përmbajtja e programit të provimit të përgjithshëm përfundimtar bazohej në disiplinat kryesore të programit të studimit të ciklit të dytë: 20% lëndë nga Kategoria A, 70% lëndë nga Kategoria B, dhe 10% lëndë nga Kategoria C.[101] Nga viti akademik 2019-2020 pesha do të jetë 80% lëndë të kategorisë B dhe 20% lëndë të kategorisë C. Gjithashtu, teza e provimit të përgjithshëm përfundimtar ndërtohej sipas formatit të posaçëm *[formati Z.IV.2.4]* ku rubrikat e vlerësimit janë të orientuara drejt pyetjeve cilësore dhe me zhvillim. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e tëmave të tëzës/diplomave. | Pedagogu udhëheqës zhvillonte seanca metodologjike me grupin e studentëve që ai udhëheq, jo vetëm për të përcaktuar temën, por edhe për t'i ndihmuar për vështirësitë që mund të kenë, gjatë punimit të saj, deri në dorëzimin e saj[102]. Edhe studentët që përgatitën për Provim të Përgjithshëm Përfundimtar kanë të drejtë të takojnë pedagogët e departamentit për t'u konsultuar për paqartësitë, sipas temës së pyetjeve të shpërndara paraprakisht. |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të tëmave dhe fushës së studimit. | Për studentët e ciklit MA, punimi i diplomës mund të ketë karakter teorik ose empirik[103]. Pedagogu udhëheqës gjatë seancave metodologjike trajtontë çështje të tilla si: trajtimin e aspekteve metodologjike, përpunimin e metodave të paraqitjes sasiore (diagrame, kurba etj); punën në terren, planifikimin, implementimin, raportimin e gjetjeve,të dhënave, etj[104]. Institucioni mund të ndihmojë studentët, duke shpërndarë pyetsorët e tyre, tek studentët e tjerë nëpërmjet koordinatorëve. Gjithashtu, institucioni nëpërmjet lëshimit të vërtetimit të studentit (me kërkesë të studentit) mund të ndihmojë proçesin e mbledhjes së të dhënave jashtë institucionit. |
| **Kriteri 6.** Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas | Seancat metodologjike përgatisnin studentët të trajtojnin çështje të tilla nën kujdesin e pedagogut udhëheqës:<br>a) Trajtimin e aspekteve metodologjike; |

[99] Dokumenti A.IV,Sistemi I vleresimitte studenteve,pika A.IV.2.3(Ref.nr.7.1)
[100] RregulloreUET,Neni39,pika2(Ref.nr.5)
[101] Dokumenti A.IV,Sistemi I vleresimitte studenteve,pika A.IV.2.3(Ref.nr.7.1)
[102] Dokumenti B.II Mbi punimin e Diplomes,pika B.II 5.2(Ref,nr.10)
[103] Dokumenti B.II Mbi punimin e Diplomes,pika B.II.6(Ref,nr.10)
[104] Dokumenti B.II Mbi punimin e Diplomes,pika B.II 5.2(Ref,nr.10)

| | |
|---|---|
| udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | b) Përpunimin e metodave të paraqitjes sasiore (diagrame, kurba etj);<br>c) Punën në terren, planifikimin, implementimin, raportimin e gjetjeve/të dhënave;<br>d) Hartimin e punimit të diplomës[105] etj.<br>Udhëheqësi i diplomës[106], garanton cilësinë e rezultateve të punimit, pasi studentët nuk mund të dorëzojnë punimin e diplomës, pa marrë miratimin e udhëheqësit. |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Provimi përfundimtar dhe punimi i diplomës vlerësoheshin me notë, e cila ishte mesatare e vlerësimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit. Rezultati përfundimtar shënohej në proçesverbal dhe bëhej publik në fund të çdo seancë të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve. |
| **Kriteri 8.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. | Në përfundim të studimeve, studenti pajisej me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Kohëzgjatja e lëshimit të diplomës ishte brenda 6 (gjashtë) muajve. Deri në momentin e pajisjes me diplomë të diplomuarve, UET-i lëshontë një vërtëtim për diplomën e fituar, të shoqëruar me çertifikatën e notave. |
| **Kriteri 9.** Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Pas përfundimit të studimeve, studenti kishte të drejtë të kërkonte një kopje zyrtare të syllabuseve të programit të studimit të zhvilluar. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore harton dhe pajis studentin me Suplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhën shqip dhe anglisht). |
| **Kriteri 10.** Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacionë për studentin, nëse kërkohen | Në lidhje me proçedurat që kryhen për ruajtjen dhe arkivimin e informacionit dhe pajisjen e studentit me informacionin e nevojshëm, institucioni i kishte të përcaktuara në dokumenta të veçanta. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohej dhe ruhej për një periudhë pa afat. Institucioni disponontë një data bazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunonte të dhëna statistikore sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjensisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vetë institucionit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

[105] Dokumenti B.II Mbi punimin e Diplomes,pika B.II 5.2(Ref,nr.10)
[106] RregulloreUET,Neni39,pika3(Ref.nr.5)

## IV. BURIMET NJËRËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Institucioni i arsimit të larte ndjek procedura ligjore dhe transparentë të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të përsonit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ. | Zyra e burimeve njërëzore[107] demonstroi se mblidhtë, ruante dhe përditsonte të dhënat e personelit të angazhuar në UET,në departamentin e Arteve të Aplikuara në "Arte muzikore" duke krijuar dosjen individuale për stafin akademik dhe të ftuar. Zyra e burimeve gjithashtu mbante dokumentacionin[108] mbi realizimin e ngarkesës mësimore për stafin akademik për çdo semestër. |
| **Kriteri 2.** Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. | Zyra e burimeve njërëzore në UET ka përcaktuar qartë kriteret, procedurat për rekrutimin e personelit akademik me kohë të plotë e të pjesshme[109] të bazuara të gjitha në përputhje me legjistacionin në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të UET. |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike. | Zyra e burimeve njërëzore sipas procedurave të përcaktuara nga UET[110] dhe në bashkëpunim me përgjegjësin e departamentit të Arteve të Aplikuara në "Arte muzikore" demonstroi se kishte hartuar kritere sipas nevojave dhe ngarkesës vjetore dhe shpallte publikisht vendet vakante dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Njoftimet bëhen në faqen zyrtare të UET, rrjete sociale[111] dhe në gazetë. |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit | UET bën vlerësimin periodik për stafin pedagogjik duke filluar nga momenti i rekrutimit dhe në vazhdim. Këto proçedura ishin të përcaktuara në dokumentët e zyrës së burimeve njërëzore.Përzgjedhja e personelit bëhej sipas shpërndarjes së ngarkesës mësimore dhe duke marrë në konsideratë ekspertizat e departamentit[112]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

[107] Dokumenti G.Rregulloreper Burimet Njerzore(Ref.nr.11)
[108] Format dosje Stafi Akademik(Ref.nr.44;44.2)
[109] Dokumenti G.Rregulloreper Burimet Njerzore(Ref.nr.11)
[110] Faqja zyrtare e UET https//uet.edu.al/rreth-uet/
[111] Shembull thirrje per staf akdemik(Ref.Nr.11.1)
[112] RregulloreUET,Neni 22,(Ref.nr.5),Dokumenti G.Rregulloreper Burimet Njerzore(Ref.nr.11)

| Standardi IV.2<br>**Institucioni i arsimit të larte ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficentë dhe efektive** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. | Istitucioni UET ka siguruar ambjentë komode (siç e vertetuam dhe me vizitën tonë në ambjentët e UET) gjë që krijon mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për personelin, studentët e pedagogët .Kapacitetet infrastrukturore janë të përshtatshme[113] për një realizim të kënaqshëm të proçesit mësimor si për studentët po ashtu dhe për pedagogët. |
| **Kriteri 2.** Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtëjshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. | UET është i angazhuar për kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik (sidomos asistent lektorët) nëpërmjet organizimit të konferencave në kuadër kombëtar po ashtu dhe ndërkombëtar.Janë të dokumentuara nga zyra e projekteve pranë UET marrvështjet me institucione brenda dhe jashtë vendit[114] (marrveshjet në kuader të Erasmus) UET ka ndërtuar skemën e financimit për kërkim shkencor për botimet në revista të indeksuara shkencore në Thomson Reuters. |
| **Kriteri 3.** Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtëjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. | UET në bashkëpunim me Qendrën e metodologjisë dhe Kërkimit[115] ofronte trajnime për rritjen e aftësive të stafit akedemik .Trajnimet ndahen në 4 grupe:<br>1- Trajnime për Doktorantë.<br>2- Trajnime për junior research.<br>3- Trajnime për senior research.<br>4- Trajnime Metodologjike. Kishte trajnime po ashtu për proçesin e dixhitalizimit nëpërmjet zyrës së TIK[116]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njërëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë | Zyra e burimeve njerëzore bënte kujdes për angazhim optimal të stafit akademik sipas ekspertizës për përmbushjen e objektivave të programeve në departamentin e Arteve të Aplikuara në "Arte Muzikore" me profile. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| Standardi IV.3<br>**Institucioni i arsimit të larte vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e proçesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kwrkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** |
|---|

[113] Infrastruktura ne funksion te programeve te studimit(Ref.nr.42)
[114] Projektet UET 2014-2020(Ref.nr.28.1(;https//uet.edu.al/inter-institucional-aggreement(Ref.nr.28.2)
[115] Strategjia e kerkimit shkencor ne UET 2017-2020;2020-2021(Ref.nr.3.1;Ref.nr.3.2));
[116] Video-trajnime mbi sisteminTEAMS/LMS;(Ref.nr.46.4)

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | UET është një institucion që siguron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme dhe të pajisura me infrastrukturë të nevojshme për veprimtaritë akademike[117]. Sipërfaqet e shfrytëzueshme janë të ndara në salla leksionesh 15, salla seminari janë 13 me sipërfaqe 561 m2 dhe 153 vënde. |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e proçesit mësimor tëorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Gjatë vizitës që kryem në UET vizituam 7 laboratorë informatike ,sallë interneti ,auditore të pajisur me mjete audio visive e PC,projector[118].Duke ndjekur zhvillimet, UET ka investuar në sisteme (moodle,LMS ) gjë që ndihmon studentët në kohë reale të përditsohen me materialet e pedagogut dhe materiale shtese audiovizive . |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atëlietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit tëorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Laboratorët, studiot apo mjedise të tjera në UET ishin në dispozicion të studentëve për realizimin e kënaqshëm të progameve të studimit teorikisht dhe praktikisht. |
| **Kriteri 4.** Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Ishin 7-laboratore në dispozicion të studentëve si dhe sallla të mjaftueshme për programet e studimit janë efikase për formimin sipas natyrës profesionale të programit të studimit. |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitëtët që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjektë të tjera (vërtëtuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike | UET demostroj marrveshje me institucione e organizata të ndryshme për zhvillimin e praktikave mësimore të cilat kanë rezultuara të suksesshme. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Standardi IV.4**

[117] Infrastruktura ne funksion te programeve te studimit(Ref.nr.42)
[118] Urdher mbi zbatimine platformesLMS,UET-LMS Guide per pedagogun;UET LMSGuideper studentet(Ref.nr.7,7.1&7.2)

| Institucioni i arsimit të larte vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe litëraturën e nevojshme në mbështetje të proçesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabarte nga studentët e programit të studimit. | UET përdor sistemin UMIS ku regjistrohen gjithë studentët nga momenti i rregjistrimit dhe përgjatë gjithë aktivitetit të tyre deri në diplomim, ky program informatik është krijuar për të ruajtur, administruar të dhënat e studentëve si ato financiare aktivitetin e bibliotekes. Një funksion i rëndësishëm i këtij sistemi është informacioni personal si rregjistrimi I notave, adresat si dhe rezultatet e provimeve. |
| **Kriteri 2.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me litëraturë fizike, si: tekstë mësimore bazë, litëraturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | UET kishte sisteme MOODLE (UETLMS)[119] ku bëhet e mundur që studentët në kohë reale të përditësohej me materiale audio vizive, leksione ku mund të shikojnë dhe informacionet e pedagogeve në çdo etapë të programit[120]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të krijojë kushtë për akses të barabarte e pa pagesë për studentët, në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | UET nëpërmjet sistemit LMS kishte mundesi të kishte akses në lëndët e tyre të profilit dhe marrin të gjithe informacionin me literature përkatëse, por nuk kishte akses në lëndët që nuk i përkasin .Secili pedagod ishte i rregjistruar në lëndët e veta dhe mund të adresoje çdo kërkesë administratës që lidhet me proçesin mësimor. |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. | Sistemi LMS i UET mundësonte komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve të studimit, detyrat afatet e dorëzimit të tyre gjë që rrit cilesinë e mësimnxënies duke patur gjithashtu mundësi të drejtoje pyetje për paqartësitë që mund të ketë. |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit. | Sistemi LMS bënte të mundur që në përfundim të çdo semestri të nxirren statistika për mënyrën e përdorimit të këtij sistemi nga çdo pedagog[121]. |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të proçesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitëtit të saj | Në faqen e UET www.net.edu.al shfaqen informacione të bollshme mbi misionin, partnerët, drejtimin dhe funksionimin organiogramën, guida për studentët e ardhshëm si dhe biografi të detajuara të pedagogëve. I gjithë ky informacion ishte i aksesueshëm edhe në gjuhën angleze. |

[119] Dokumenti E-IV-2, Formular per pasurimin e literatures ne bibloteke (Ref.nr.45.2); Inventari I teksesve ne fushen e programit (Ref.nr.45) Te dhena statistikore per fondin e biblotekes.Infrastruktura ;( Ref.nr.42).
[120] Aneks: Tabelat permbledhese.Tabela Nr.17.Te dhena per platformatonline/infrastrukturatIT/Bibloteka.
[121]Dokumenti E-IV-2,Formular per pasurimin e literatures ne bibloteke(Ref.nr.45.2); Dokumenti E-IV.Mbi funksionimin e Biblotekes;shembull procedure blerje literature(Ref.nr.45.2;45.1;45.3);Infrastuktura ne funksion te bprogramevete studimit(Ref.Nr.42)

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi IV.5<br>Institucioni i arsimit të larte disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | UET demostroj një politikë financiare sipas të cilës harton çdo muaj tetor një buxhet vjetor ku parashikohen çdo muaj dhe planifikohej një raport i drejtë i të ardhurave me rezervat[122] .Kjo politikë hartohej nga administrotori i zyrës së financës .Çdo veprim financiar kryhej nëpërmjet bankës për të siguruar transparencë të plotë. |
| **Kriteri 2.**Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnërëve të angazhuar në realizimin e programit. | Plani financiar hartohej në nivel institucioni, ndryshe nga institucionet publike të arsimit të lartë ku buxheti hartohet mbi bazën e çdo program studimi[123]. |
| **Kriteri 3.**Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacionë e dokumentë për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | UET kishte kryer auditim institucional të drejtuar nga DELOITE ALBANIA gjatë vitëve 2016 -17 dhe çdo vit hartohej raport në lidhje me transparencen financiare. Pasqyrat financiare paraqesnin në menyre të drejtë të gjitha aspektet materiale si dhe pozicionin financiar. |
| **Kriteri 4.**Sistemi i menaxhimit ka të intëgruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit intëraktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. | UET kishte raport auditi çdo vit. Raportet përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe kategorizimin në llogaritë përkatëse, shfrytëzimin dhe efiçencën e të ardhurave për funksionimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve për studentët. |
| **Kriteri 5.**Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. | Institucioni I UET dëshmon sipas të dhënave financiare se ka qëndrushmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit po ashtu dëshmon kapacitete për gjenerim të të ardhurave në të ardhmen. |
| **Kriteri 6.** Informacionët që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të | UET[124] demostroj një politikë financiare sipas të cilës harton çdo muaj tetor një buxhet vjetor ku parashikohen çdo muaj dhe planifikohej një raport i drejtë i të ardhurave me rezervat .Kjo politike hartohej nga |

[122] Manual i perdoruesit te sistemit UMIS(Ref.nr.46)
[123] Manual i perdoruesit te sistemit UMIS(Ref.nr.46)
[124] Dokumenti e.v.Mbi politikat e prezantimit/promovimit te UETon line(Ref.nr.48)

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| pakten dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe | administrotori i zyrës së financës .Çdo veprim financiar kryhej nëpërmjet bankës për të siguruar transparencë të plotë. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Standardi IV.6** **Institucioni i arsimit të larte garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e proçesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të pakten një cikël të plotë studimi. | UET si unstitucion jo publik[125] demostroj një politike financiare sipas të cilës harton çdo muaj tetor një buxhet vjetor ku parashikohen çdo muaj dhe planifikohej një raport i drejtë i të ardhurave me rezervat .Kjo politikë hartohej nga administrotori i zyrës së financës .Çdo veprim financiar kryhej nëpërmjet bankës për të siguruar transparencë të plotë. |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njërëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet opërative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të proçesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantët vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij. | Plani financiar hartohej në nivel institucioni, ku përfshiheshin të gjithë kostot dhe të ardhurat[126], ndryshe nga institucionet publike të arsimit të lartë ku buxheti hartohet mbi bazën e çdo program studimi. |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributëve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. | UET kishte kryer auditim institucional të drejtuar nga DELOITE ALBANIA gjatë vitëve 2016 -17 dhe çdo vit hartohej raport në lidhje me transparencën financiare. Pasqyrat financiare paraqesnin në mënyre të drejtë të gjitha aspektet materiale si dhe pozicionin financiar. |

125 Paqyrat financiare me shenime(Ref.nr.50.1,50.3) Raportet e auditimit(Ref.Nr.50.4-50.6)

126 Aneks: Tabelat permbledhese.Tabela 18.1: Te dhena mbi kostonper student; Tabela 18.2: Te ardhura dhe financime te ndryshme.

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. | UET kishte raport auditi çdo vit .Raportet përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe kategorizimin në llogaritë përkatëse, shfrytëzimin dhe efiçencën e të ardhurave për funksionimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve për studentët. |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitëtë financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenërimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen | Institucioni i UET dëshmon sipas të dhënave financiare se ka qëndrushmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit po ashtu dëshmon kapacitete për gjenërim të të ardhurave në të ardhmen. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## V. STUDENTËT DHE MBESHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të larte harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomiminnë programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Institucioni UET kishte botuar një broshurë informuese (Guida UET[127]) ku përshkruheshin qartë proçedurat për pranimin e studentëve, burimet njerëzore, kapacitetet njerëzore e infrastrukturore[128]. Institucioni kujdesej po ashtu për ecurinë e studentëve gjatë gjithë ciklit të studimeve duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi. |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë | Kriteret e politikat e Institucionit për hyrje e deri në dalje ishin të garantuara nga rregullorja (Guida UET) ku garantoheshin të drejta të |

[127] Dokumenti D.I.Mbi politikat,kriteret dhe procesin e pranimit te studenteve(Ref.nr.27.1)
[128] https//uet.edu.al/new/si-te-aplikojme/

| | |
|---|---|
| barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | barabarta për gjithe kandidatët për studentet e studentët e çdo program studimi[129]. |
| **Kriteri 3.** Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Kriteret, proçedurat ishin lehtësisht të aksesueshme duke garantuar transparencë të plotë për të gjithë. Këto kritere e proçedura ishin të aksesueshme on line si dhe i ofrohej kjo mundësi të interesuarve gjatë vizitës në institucion[130]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve. | Çdo program studimi në UET pranonte kandidatët në varësi të kapaciteteve infrastrukturore e akademike sipas kritereve që përcakton departamenti dhe miratohen nga senati akademik .Numri i studentëve, mënyra e përzgjedhjes bëhen publike çdo fillim viti akademik në faqen e Institucionit. |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të larte udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit | Përpara fillimit të çdo viti akademik UET organizonte një fushatë informimi, sensibilizimi për të gjithë të interesuarit që kanë dëshirë të studiojnë në këtë Universitet. Institucioni investon mjete financiare për të organizuar një fushatë në gjimnaze, këshillim në hollin e universitetit. Institucioni organizon po ashtu një "Javë Orientuese" për studentët e rinj (leksione shpjegim rregulloreje, procedura administrative si dhe njohje me kapacitetet infrasrukturore.[131]<br>Për të gjithë studentet e rinj të regjistruar realizohej "Java e Orientimit".Gjatë kësaj jave realizohen takime leksione,për shpjegimin e sistemit të studimeve,rregulloreve dhe proçedurave administrative të UET;njihen me ambientet ku do të zhvillohet mësimi etj.[132] Kriteret e programeve të studimit publikoheshin dhe i vihen në dispozicion palëve të interesuara nëpërmjet rrugëve dhe instrumenteve të ndryshme të komunikimit[133]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

[129] Rregullore UET,nei42(Ref.nr.5)

[130] Dokumenti D.II.Mbi transferimet,njohjet e krediteve dhe mobilitetin (Ref.nR.28); Dokumenti E.VII Mbi funksionin e Zyres se Keshillimit te Karrieres dhe Kujdesit ndaj Studentit(Ref.nr.12) Dokumenti A.V.Mbi tutoriatin,Keshillimin akdemik dhe keshillimin metodologjik(Ref.nr.27.2);Rregullore mesimore e programit te studimit(Ref.Nr.7).

[131] Politika e marketingut te programit te sudimit (Ref.nr.51) ;) Dokumenti E.V.Politikate prezantimit dhepromovimit te UET online (Ref.nr.48).

[132] Rregullore mesimore e programit te studimit (Ref.Nr.7).

[133] Komunikimi I integruar I marketingut (Ref.nr.51); Dokumenti E.V.Politikate prezantimit dhepromovimit te UET online (Ref.nr.48).

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të larte vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Në Rregulloren e UET gjëndej material i plotë informues për kriteret e proçedurat e përparimit akademik të studentëve si dhe proçedurat të kalimit nga një vit në tjetrin materiale të cilat i vihen në dispozicion studentit nga koordinatorja e departamentit (formulari i paradiplomimit, rezultatet respektive si dhe statusi i studentit në çdo lëndë.)[134] |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Institucioni kishte një proçedurë për njohjen e kualifikimeve të mëparshme si dhe studimeve të mëpërparshme nëpërmjet Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit në bashkëpunim me Departamentin ku informon studentët e interesuar për të transferuar studimet e tyre në UET[135]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | UET organizonte "Javën Orientuese" për studentët e rinj për të informuar studentët e rinj mbi kriteret e proçedurat për vlerësimin e dijeve, programet dhe stafin pedagogjik. Gjatë kësaj jave orientuese studentëve i vihen në dispozicion po ashtu dhe syllabuset për çdo lëndë e program studimi. |
| **Kriteri 4.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Studentët e ciklit të dytë të studimeve Master në UET u krijohej mundësia me njohjen e kritereve për procedurat e diplomimit[136]<br>1- Provim i Përgjithshem Përfundimtar (një formë) ose<br>2- Temë Diplome.<br>Këto alternativa studenti i zgjedh në konsultim me pedagogun udhëheqës duke përcaktuar kalendarin e seancave, proçesin e shkrimit të tezës, formatin e hartimit. Gjithashtu studenti njoftohej nëpërmjet një mail për çdo veprimtari akademike[137] që organizohet në UET. |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit | UET organizonte çdo pranverë fushatë promovuese me grupe pune të përbërë nga pedagogë e student duke vizituar shkolla të mesme në qytete të ndryshme të vendit për promovimin e këtij Institucioni. UET po ashtu organizonte Open DAYS ku maturantë nga shkolla të ndryshme të vendit mund të vizitonin ambjentet e UET si dhe mund të bashkëbisedonin me pedagogë të institucionit për të informuar të interesuarit mbi programet, stafin infrastrukturën etj. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

[134] Rregullore mesimore e programit te studimit (Ref.Nr.7).
[135] Dokumenti D.II.Mbi transferimet, njohjet e krediteve dhe mobilitetin (Ref.nR.28).
[136] Dokumenti B.II.Mbi punimin e diplomes dhe dizertacionit (Ref.nr.10)
[137] Kalendari akademik (Ref.nr.10.1; 10.2; 10.3; 10.4.)

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të larte vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. | Informacioni mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit u vihej në dispozicion studentëve nëpërmjet 1- Këshillimit me stafin akademik. 2- Kontakteve me Zyrën e Kujdesit ndaj Studentit 3- Rregullorja mësimore e programit të studimit .4- Kontrata e nënshkruar në momentin e rregjistrimit[138]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | UET vinte në dispozicion të studentëve programin e detajuar çdo fillim viti akademik. Informacion gjendej në faqen zyrtare të UET. Në formë të detajuar studentët merrnin informacion e akses mbi temat për çdo javë mësimore, literaturën përkatëse, detyrat apo diskutime nëpërmjet LMS.Studentët e vitit të 2-të merrnin sërish informacion në momentin e përzgjedhjes së lëndës nga pedagogu përgjegjës. |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | UET kishte mjetet e tij për orientimin e studentëve drejt tregut të punës<br>1- Zyra e Këshillimit të Karrierës[139] së studentëve e cila bashkëpunonte me këshilltarët e karrierës së çdo fakulteti, departamenti.<br>2- Bordet e tregut të punës[140].<br>3- Organizonte panaire të punës dhe aktivitete me aktorë të tregut të punës[141].<br>4- Dërgonte njoftime në mënyrë permanente tek studentët mbi mundësi të ndryshme punësimi. |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e proçesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Bazuar në akte nënligjore dhe ato rregullatore të UET koordinatorja e departamentit mbante vazhdimisht në kontakt dhe azhornonte studentët në lidhje me programet, lëndët, modulet nga momenti i rregjistrimit e në vazhdim. Çdo ndryshim në orar[142] ose ndryshim gjatë zbatimit të tij u bëhej me dije studentëve nëpërmjet postës elektronike apo nëpërmjet sistemit LMS. |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet | Studentët e UET nga momenti i rregjistrimit pajiseshin nga zyra IT me adresë E-Mail. Kjo ishte një mundësi që studentët të marrin të gjithë informacionin zyrtar që dërgohej nga koordinatori i departamentit edhe në rastet kur student mund të ishte në distancë për të marrë njoftimet e pedagogëve, orare të personalizuara, chat me pedagogët etj. |

[138] Rregullore mesimore e programit te studimit (Ref.Nr.7).

[139] Dokumenti E.VII Mbi funksionin e Zyres se Keshillimit te Karrieres dhe Kujdesit ndaj Studentit(Ref.nr.12)
[140] Bordi I tregut te punes 2018-2019(Ref.nr.12.1)
[141]Poster Panairi I punes 2018-2019(Ref.nr.12.2) https//uet.edu.al/nce/punimet-e-studenteve-ne-uet-perballja-e-pare-me-tregun-e-punes/.

[142] Dokumenti E.I. Mbi funksionimin e sekretaries mesimore,pika E1.6.3(Ref.nr.9)

| | |
|---|---|
| të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | |
| **Kriteri 6.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve | I gjithë dokumentacioni i studentit,që nga dosja për aplikim dhe rregistrim në programin e studimit,si dhe gjithë rekordet(lëndët që ka ndjekur çdo semester,rezultatet e provimeve,deri në përfundim)ruhen në sekretarinë mësimore dhe Zyrën e Rregjistrimit të studentit,përkatësisht. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të larte mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. | Në secilin program studimi[143] në UET kishte të dhëna për numrin e studentëve të diplomuar si dhe statistika për cilësinë në hyrje, në dalje, po ashtu dhe për punësimin.<br>Gjate viteve akademike 2020-2021 cilësia në hyrje ishte 1 student dhe cilësia në dalje 2 student, 2021-2022 cilësia në hyrje 4 student. |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit. | UET disponoːnte statistika mbi numrin e studentëve si rregjistrimet[144], transferimet, ç'rregjistrimet, kalueshmërinë cilësinë në hyrje dhe dalje dhe shkallën e punësimit. Sistemi UMIS mundësonte që të dhënat statistikore të përpunoheshin në çdo kohë pra për të gjithë gjeneratat e të diplomuarve që nga viti i 1-rë akademik. (Këto të dhëna ishin të pasqyruara në Dokumentin mbi funksionin e sekretarisë mësimore). |
| **Kriteri 3.** Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre. | Çdo student kishte dosjen e tij me rekordet që nga rregjistrimi deri në ditën e diplomimit. Këto të dhëna ruheshin si në mënyrë elektronike po ashtu në dokumenta tek sekretaria mësimore. |
| **Kriteri 4.** Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga përsonat e autorizuar. | UET përdor Sistemi Menaxhimit të Universitetit (UMIS) një program informatik që mundëson ruajtjen, administrimin, dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit. Këto të dhëna administrohen nga personi pranë zyrës së IT të UMIS dhe ishin të aksesueshme me autorizimin e autoriteteve të Universitetit. |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë raportë analitike periodike mbi | Departamenti analizonte dhe hartonte një raport mbi arritjen e objektivave të programeve dhe po ashtu të rezultateve të pritshme mbi |

[143] Cilesia ne hyrje dhe dalje( Ref.nr.27)

[144] Dokumenti E.I. Mbi funksionimin e sekretaries mesimore,pika E1.6.3(Ref.nr.9)

| | |
|---|---|
| profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve | realizimin e cilësisë në mënyrë që të identifikojë nevojat e mundësitë e përmirësimit në të ardhmen[145]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të larte përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. | Studentët përfaqesoheshin në organet drejtuese të institucionit, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve.<br>UET-i inkurajon pjesmarrjen e studentëve në vendimarrje,organizimin e lirë dhe shprehjen e mendimit të tyre[146].Ndër strukturat kryesore ishin:<br>-Këshilli I studenteve.<br>-Senati akademik.<br>-Këshilli I Etikës.<br>-KSBC.<br>Mbledhjet e departamenteve organizoheshin një herë në muaj dhe janë të hapura për studentet. |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi proçesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Përpara përfundimit te semestrit studentët bënin vlerësimin anonim të pedagogeve me të cilët kanë bërë mësim.Ky vlerësim bëhej elektronikisht nëpërmjet sistemit LMS,me një sërë pyetjesh mbi cilësinë e zhvillimit të mësimit nga pedagogu.Një mënyrë tjeter ishin dhe "Focus Group",me grupe studentësh të programeve përkatëse,për të trajtuar shqetësimet dhe pritshmërite e tyre.Departamenti vetë kryente mbledhje të hapura me pedagogë e student për të kontrolluar mbarëvajtjen e studimeve dhe për të shprehur të gjithë mendimet apo problematikat nga studentët[147]. |
| **Kriteri 3.** Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të | UET[148] në aktet statuore dhe rregullatore që ishin të aprovuara në senatin akademik demonstronte që i kishte parasysh ngarkesën akademike të |

[145] Analiza e departamentit per programin( Ref.nr.38)
[146] Statuti UET,Neni16,19 dhe 51 (Ref.nr.2)
[147] Rregullore UET, Neni22, pika2 (Ref.Nr.5).

[148]Dokumenti D.II.Mbi transferimet, njohjet e krediteve dhe mobilitetin (Ref.nR.28). Rregullore UET, Kreu VII, Neni 35,(Ref.Nr.5).

| | |
|---|---|
| mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme. | studentëve në programin e studimit, shpërndarjen e lëndëve nëpër semestra dhe ngarkesën e shprehur në kredite. |
| **Kriteri 4.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në proçesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to. | UET kishte në politikën e tij përfshirjen e studentëve në hartimin, rishikimin e përmirësimin e programeve, syllabuseve nëpërmjet një pyetsori që bëhet çdo semestër nëpërmjet departamentit. Në këtë pyetsor përfshiheshin gjithë lëndët, programet syllabuset e pedagoget po ashtu përfundimet e dala nga ky proçes ishin pjesë e diskutimeve dhe mund të sugjeroheshin si ndryshime të programit të studimit. |
| **Kriteri 5.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së proçesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës | Duke shqyrtuar dokumentacionin e rregullores së brendshme[149] vërejmë që mënyra e kontrollit dhe vlerësimi i dijeve ishte një proçes transparent. Sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim ishin tregues për një proçes transparent. Studentët kishin mundësi të parashtrojnin kërkesat e tyre duke plotësuar një formular[150]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.6**<br>**Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë nëaktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| Kriteri 1.Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor. | Personeli akademik i Departamentit të Arteve të Aplikuara në "Arteve Muzikore" kishte mundësinë e publikimit rregullisht të artikujve,materialeve shkencore në disiplinën përkatëse[151].UET u ofronte pedagogëve mundësinë për të publikuar në revistën ndërkombëtare shkencore POLIS dhe për të referuar në konferencën ndërkombëtare "Ditët e Studimeve Shqiptare". |

149 Rregullore UET, Neni24, 27 dhe 32(Ref.Nr.5).

150 Formati I Sallabusit( Ref.nr.19.1)
151 Publikimet dhe veprimtaria kerkimore e stafit 2017-2020(Ref.nr.43)

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Institucioni lidh marrëveshje partnëritëti me institucionet e huaja të arsimit të larte, institutë, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta. | UET demonstroi që ka lidhur marrëveshje partneriteti me institucione homologe, brenda dhe jashtë vendit[152].Marrëveshjet kanë si qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.<br><br>• Marrëveshje e lidhur ndërmjet Universitetit Europian të Tiranës dhe Universitetit të Arteve me Nr. 889 Prot. Datë, 17. 07. 2018.<br>• Marrëveshje e lidhur ndërmjet Universitetit Europian të Tiranës dhe Bashkisë Tiranë me Nr. 89 Prot. Datë, 01. 04. 2019.<br>• Marrëveshje e lidhur ndërmjet Universitetit Europian të Tiranes dhe Gazetës Liberale me Nr. 198 Prot. Datë, 17. 07. 2019.<br>• Marrëveshje e lidhur ndërmjet Universitetit Europian të Tiranës dhe Studios Muzikore *On off Production* me Nr. 196 Prot. Datë, 16. 07. 2019.<br>• Marrëveshje e lidhur ndërmjet Universitetit Europian të Tiranës dhe Shtëpisë Botuese UET PRESS me Nr. 197 Prot. Datë, 17. 07. 2019.<br>• Marrëveshje Nr. 317 Prot. Datë 28. 12. 2021, nënshkruar ndërmjet Universiteti Europian të Tiranës dhe Kompanisë Filmike A.A.<br>• Marrëveshje e lidhur ndërmjet Universitetit Europian të Tiranës dhe Organizatës Jofitimprurese *Harabel* me Nr. 117 Prot. Datë, 15. 04. 2022.<br>• Marrëveshje e lidhur ndërmjet Universitetit Europian të Tiranës dhe Qendrës së Zhvillimit "Pëllumbat" Tiranë me Nr. 63 Prot. Datë, 17. 02. 2022. |
| **Kriteri 3.**Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore. | Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore ose aktivitete artistike. Studentët përfshihen në punime individuale me pedagogët. |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve. | Sipas RVVB-se, UET ka krijuar një fond prej 75 000 Eurosh, për të nxitur stafin, për të kryer një punë kërkimore shkencore cilësore dhe të botoje në revista me faktor impakti. |
| **Kriteri 5.** Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patëntave. | Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështesin studentët të angazhohen në studime inovative apo aktivitete të tjera që shërbejnë në rritjen e tyre profesionale. |
| **Kriteri 6.**Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës | Personeli akademik nëpërmjet seancave metodologjike me studentin dhe asistencën e nevojshme bashkëpunon që në përcaktimin e temës deri në momentin e mbrojtjes së diplomës[153]. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |

[152] Marrveshjet e bashkepunimit (Ref.nr34).

[153] Dokumenti B.II.Mbi punimin e diplomes dhe dizertacionit(Ref.nr.10)

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | | | **X** |

| **Standardi V.7**<br>**Mbeshtetja e institucionit të arsimit të larte siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit. | Sipas RVVB-së UET ka hartuar një strategji ndërkombëtarizimi në nivel institucional. UET ka lidhur marrëveshje (memorandum bashkëpunimi) me ILA në Europë, Amerikë, Kinë[154]. Pjesë e këtyre marrëveshjeve është dhe mobiliteti i studentëve dhe stafit akademik, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave[155]. |
| **Kriteri 2.** Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve. | Në programin e MA në "Arte Muzikore", studentët zhvillojnë lëndë që do të kërkojnë një ristrukturim akoma më korrekt [156]dhe me hapësira metodologjike më aktive. |
| **Kriteri 3.** Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj. | Institucioni ka të përcaktuar qartë politikat e përfshirjes së studiuesve të rinj[157] në projekte kërkimore. UET ka ndërtuar 7 Projekte të Mëdha Kërkimore (PMK) të cilat perbëjnë shtyllat e kërkimit shkencor. |
| **Kriteri 4.** Institucion ndjek një politikë intëgruese për kërkuesit shkencorë të huaj. | UET në sajë të bashkëpunimit me institucione të tjera homologe, rrit bashkëpunimin ndërmjet stafit dhe përfshirjes shkencore të tyre dhe pjesëmarrjen e tyre në Konferenca ndërkombëtare. |
| **Kriteri 5.** Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetitin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare. | UET- ndjek politika favorizuese për student [158]në kuadër të ndërkombëtarizimit dhe rritjes së mobilitetit të tyre. |
| **Kriteri 6.** Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, përsonël akademik dhe studentë të huaj, për përiudha të ndryshme kohore | Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për të marre pjesë në konferencat shkencore që zhvillohen në semestra të ndryshëm. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

[154] Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkepunuese;Marrveshjet e bashkepunimitUET;Marrveshje bashkepunimi per programin(Ref.m\nr.32,34)
[155] Te dhena mbi shkembimin e stafit dhe studenteve te programit te studimit( Ref.nr.43.1)
[156] Kurrikula e Programit te Studimit (Ref.Nr.14).
[157]Strategjia e kerkimit shkencor ( Ref.nr.14)
[158]Te dhena mbi projektet dhe shkembimin e stafit dhe studenteve(Ref.nr.43.1)

| **Standardi V.8**<br>**Institucioni i arsimit të larteka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat opërojnë në mënyrë përmanëntë e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. | UET kishte një njësi të posaçme të informimit të studentëve që quhej zyra e Kujdesit ndaj Studentëve[159]. Tutoriati dhe këshillimi akademik, si dhe këshilluesit e karrierës në çdo department ishin gjithashtu në shërbim të informimit të shërbimit për studentët.[160] |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me proçesin mësimor dhe programin e studimit. | Këshillimi dhe asistenca e vazhdueshme në bazë departamenti jepte garanci për informimin, këshillimin, përparimin e studentëve duke kombinuar aktivitetin e zyrave administrative në sistemin e këshillimit. |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e proçesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Zyra e Karrierës pranë UET[161] ishte në shërbim të studentëve për të dhënë informacionetë ndryshme në lidhje me aktivitete brenda e jashtë vendit, ofronte gjithashtu asistencë për kryerjen e aplikimeve në kompani private e shtetërore jo vetëm për kryerjen e praktikave mësimore por edhe për një punësim të mundshëm të tyre në të ardhmen. Çdo department kishte një pedagog të emëruar si këshillues karriere i cili jepte ekspertizë për zhvillimin profesional të karrierës së studentëve[162]. |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse | Zyra e Këshillimit të Karrierës në UET mbante kontakte me student të diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin. Ishte krijuar edhe Zyra Alumni e cila organizonte takim me ish studentë të suksesshëm në mënyrë që të tërhiqen mendime për përmirsimin e ofertës akademike në bazë të kërkesave të tregut[163]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

159 Dokumenti E.VII Mbi funksionin e Zyres se Keshillimit te Karrieres dhe Kujdesit ndaj Studentit(Ref.nr.12)
160 Dokumenti A.V Mbi tutoriatin,keshilliminakademikdhe keshillimin metodologjik(Ref.Nr.27.2)
161 Dokumenti B.1.Mbi praktiken profesionale,pikaB.1,2,3(Ref.nr.3.2.1)
162 Dokumenti B.1.Mbi praktiken profesionale,pikaB.1,2,3(Ref.nr.3.2.1)
163 Statuti UET, Neni 11&16(Ref.nr.2); Rregullore UET (Ref.nr.5); Mbi sigurimin e brendshem te cilesise (Ref.nr.8).

# VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të larte harton dhe zbaton politika e procedura transparentë të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | Njësia e posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëvenë UET është zyra e Kujdesit ndaj Studentit[164]. Kjo zyrë ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për cështje akademike dhe studentore. Tutoriati dhe këshillimi akademik, sikurse dhe këshilluesit e karrieres në çdo Departament janë gjithashtu në shërbim të informimit dhe shërbimit të studentëve. |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | Kombinimi i aktiviteteve të zyrave administrative[165] dhe sistemit të këshëllimit[166] në bazë të secilit department, ishin tregues të ngritjes dhe mirëfunksionimit të një sistemi të përshtatshëm të informimit, këshillimit dhe asistencës së vazhdueshme për studentët. |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentët e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e larte realizohet përmes proçeseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proçeseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. | Zyra e Karrierës ishte në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohesisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm[167]. Kjo zyrë kishte krijuar kontakte të shumta me kompani private dhe institucione shtetërore dhe bashkëpunonte ngushtë jo vetëm në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale/intershipeve të studentëve pranë këtyre institucioneve, por edhe në kuadër të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata. Çdo department kishte një pedagog, të cilit i është caktuar roli i Këshilluesit të Karrierës, i cili u jepte njohuri të përgjithshme të zhvillimit profesional dhe karrierës studentëve. |
| **Kriteri 4.** Institucioni ka hartuar një politikë të qarte dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e | Zyra e Këshillimit të Karrierës mbante kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazët ë dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve në UET ose institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Që nga viti 2009 kur u diplomuan studentët e parë, në UET ishte ngritur edhe Zyra Alumni, me përfaqësuesit e së cilës zhvillohen |

[164] Statuti UET, Neni 11&16(Ref.nr.2); Rregullore UET (Ref.nr.5); Mbi sigurimin e brendshem te cilesise (Ref.nr.8).
[165] Te dhena per indicide t e angazhuar ne KSBC_Tabela24 Aneks(Ref.nr.30;Urdher mbi perberjen e KSBC(Ref.nr.30.4)
[166] Dokumenti F.VII.Mbisigurimin e brendshem te cilesise,PikaF.VII,5( Ref.nr.8)
[167] Te dhena per numrin e programeveqe ofrohen nga departamenti( Ref.Nr.26)

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit | takime të vazhdueshme për të vjelur mendime në lidhje me përmiresimet e mundshme që do të duhen të bëhen në organizmin dhe ofertën akademike të institucionit për t'iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve bashkëkohore në vend e më gjerë[168]. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të larte monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë. | UET ka ndërtuar strategji e politika për sigurimin e cilësisë duke garantuar përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi dhe duke respektuar vendimet e senatit akademik. Nëpërmjet kësaj strategjie UET ka hartuar rregullore të brendshme në përputhje me vizionin e përcaktuar nga strukturat administrative[169]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni përdor mekanizma e proçese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë. | Struktura e përcaktuar nga UET për sigurimin e cilësisë se brendshme është KSBC (komiteti i sigurimit të brendshem të cilësisë), funksiononte si një strukturë e përherëshme prej vitit 2011. Kjo strukture kishte akses në të gjithë të dhënat e UET. UET po ashtu kishte ngritur organe Këshilluese si Bordet e Tregut të punës në mënyrë që të ketë ekspertizë për sigurimin e cilësisë së programeve në raport me kërkesat e tregut. UET kishte gjithashtu një strukturë për sigurimin e cilësisë ZSC[170] (zyra e sigurimit të cilësisë) e cila hartonte politika, strategji, proçese dhe udhëzime në funksion të politikave të UET si dhe të monitoronte zbatueshmërinë e këtyre objektivave prej njësive akademike e administrative. |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumentë matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. | Sigurimi i cilësisë në UET kryhej nëpërmjet përfshirjes së personelit akademik[171] dhe atij administrativ si dhe strukturave KBSC, dhe ZSC si dhe tërheqjes së mendimit të studentëve e anëtarëve të bordeve të tregut të punës. UET po ashtu bashkëpunonte ngushtë me ASCAL, po ashtu UET i është nënshtruar vlerësimeve periodike të jashtme në mënyrë Institucionale duke marrë vlerësime pozitive. |
| **Kriteri 4.** Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | KSBC (Komiteti i Sigurisë së Brendshme të Cilësisë) sipas një plani kalendarik të përvitshëm harton strategji për mbështetje të strukturave akademike dhe raporton tek drejtuesit e UET rreth monitorimeve me synim |

[168] Strategjia per sigurimin e brendshem te cilesise2017-2022(Ref.nr.26)
[169] Plani I veprimit KSBC(Ref.nr.30.1)
[170] Vendimi per emrimin e Koordinatoreve te programeve te studimit( Ref.nr.36)
[171] Shperndarja e relacionit te KSBC per monitorimin e syllabuseve(Ref.nr.30.7)

| | |
|---|---|
| | përmirësimin e performancës të njësive bazë si dhe të individëve në të ardhmen. |
| **Kriteri 5.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë | Raportet e vlerësimit evidentojnë përputhshmërinë e aktiviteteve me akte rregullatore dhe standartet e cilësisë.<br>KSBC-ja dhe strukturat e tjera, monitorojnë proçesin e marrjes së masave në kuadër të adresimit të mangësive. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi VI.3**<br>**Institucioni i arsimit të larte përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumentë matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtëjshme të studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të larte e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike. | Vlerësimi nga KSBC bëhej në nivel institucional dhe si i tillë shtrihej në të gjithë programet e studimit dhe nuk hartoheshin relacione specifike në bazë të programit, por nga analiza e përgjithshme, secili department përgjegjes për ofrimin e programit të studimit evidentonte elementët që lidhen me programet specifike. Këto vlerësime ishin pjesë e vetëvleresimeve në kuadër të akreditimit institucional dhe programeve të studimit. |
| **Kriteri 2.** Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumentë të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. | UET përveç njësisë KSBC përdorte dhe metoda të tërthorta për sigurimin e cilësisë si provimet, syllabuset, literaturë etj që monitoroheshin nga administrata e institucionit. Një vend të vecantë në strukturën KSBC zë dhe përfaqësuesi i studentëve. Instrumenti kryesor në përfshirjen e studentëve është pyetsori online, focus-grupe si dhe mbledhje të hapura të departamenteve etj[172]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime | UET në kuadër të vlerësimit[173] të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta si:<br>1-Teste të standartizuara.<br>2-Dëgjime në auditor.<br>3-Vlerësim me pikë.<br>4-Testime paraprake dhe përfundimtare, provime për module, praktikë<br>5-Vlerësim i detyrave të kryera nga studentët.<br>6-Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve të praktikës. |

[172] Plani I veprimit KSBC(Ref.nr.30.1)

[173] G.III.4.I Formulari vleresimit te pedagogut nga eprori-kolegu(Ref.nr.30.8)

| | |
|---|---|
| ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtëtit për profesionët e rregulluara dhe të tjera. | Për stafin akademik të kategorisë Lektor, Asistent Lektor, zhvillohen vizita nga dekani, përgjegjësi i departamentit, gjatë një ore mësimi dhe ky proçes përfundontë me një raport vlerësimi. Në kushtet e Pandemisë ishte zhvilluar mësimi on linepërmes platformave të UET me vendim senati. Monitorimi ishte bërë i mundur nga zyra e IT e cila kishte akses të autorizuar nga UET dhe nga përgjegjësit e departamenteve. |
| Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumentë të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetëncave të përftuara nga ky program | Institucioni në kuadër të vlerësimit të realizimit të veprimtarisë akademike përdorte metoda të tërthorta si :<br>1-Sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve.<br>2-Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës e të të mësuarit.<br>3-Pyetje konceptuale.<br>4-Intervista.<br>Këto rezultate të nxjera nga këto metoda u viheshin në dipozicion drejtuesve të fakulteteve të cilat reflektohen në vlerësimet e performances për çdo pedagog në përfundim të çdo viti akademik. Kujdes tregohet veçanërisht për intervistat që zhvillohen me studentët e pedagogët gjatë performancës së tyre. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të larte përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proçeset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | Përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, të interesuar në sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programeve të studimit, sigurohej përmes disa formave të parashikuara në politikat dhe aktet rregullatore të procedurave të brendshme të UET. Një nga këto politika, ishte ngritja pranë departamenteve e organeve këshilluese të Bordeve të Tregut të Punës. Po ashtu, përfshirja dhe angazhimi në KSBC i një eksperti të jashtëm i përgjigjej nevojës së Universitetit për tu konsultuar me aktore të jashtëm[174]. Aspektet positive të përfshirjes në këto projekte lidhej me shkëmbimin e përvojave, njohja me qasje të reja dhe të ndryshme, trajnimet dhe vizitat studimore, sikurse dhe me rishikimet e akteve rregullatore, metodologjise dhe instrumentëve për monitorimin dhe vlerësimin e proçeseve në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë. |

[174] Te dhena per anetaret Enjsbc(Ref.nr.30)Urdher administrative mbi perberjen e KSBC(Ref.Nr.30.4)

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | Përgjegjesitë dhe detyrat e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë ishin të përcaktuara në aktet rregullatore të Universitetit[175]. Po ashtu, në funksion të ruajtjes së përmirësimit të cilësisë, kishte detyrime dhe përgjegjësi konkrete institucionale çdo njësi: Departamenti, koordinatori i programit, zyra e karrierës, sekretaria. |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit. | Në dokumentin që rregullonte veprimtarinë lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë përcaktoheshin detyrat dhe përgjegjesitë e aktorëve të angazhuar. KSBC përbëhej nga Kryetari I Komisionit, një përfaqësues nga pedagogët e çdo fakulteti, një përfaqësues nga personeli ndihmës-akademik ose administrativ, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe të paktën një përfaqësues eksperti jashtëm. |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proçeset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë intëgritëtin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | Ky kriter përmbushej duke qenë se nëpër zgjedhjen e anëtarëve të KSBC, që kryente proçeset ciklike të vlerësimit, merreshin parasysh kriteret e mëposhtme:<br>-Kompetencat profesionale;<br>-Paanshmëria;<br>-Mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin;<br>-Shkalla e nevojshme e njohjes së anëtarëve të Komisionit;<br>-Të mos jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të UET; etj. |
| Kriteri 5. Pjesë aktive e proçeseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj | Ky kriter përmbushej nëpërmjet angazhimit të ekspertit të jashtëm në strukturën e KSBC-se, nëpërmjet takimeve me Bordin e Tregut të Punës. Edhe pjesëmarrësit që UET kishte patur në projektet e lidhura me sigurimin e brendshëm të cilësisë, ishin tregues të angazhimit të aktorëve të jashtëm në proçeset e lidhura me sigurimin e brendshëm të cilësisë[176]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.5**<br>**Politikat, proçeset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparentë dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparentë | Veprimtarinë e saj KSBC-ja e zhvillonte sipas një plani kalendar, planitë veprimit, të përvitshëm, në të cilin programoheshin monitorimet në sektoret apo proçeset që i nënshtroheshin vlerësimit |

[175] Statuti UET,Neni 11,16,20.5,20.6,(Ref.nr.2)Aneks:Per percaktimin e detyrave te koordinatoritte programit te studimit(Ref.nr.36).
[176]Fisha e projektit ENCHASE.(Ref.nr.30.9)Fisha e projektit QAinAL.(Ref.nr.30.10)

| | |
|---|---|
| dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | e që shoqëroheshin me raportet e detajuara dhe raportet përmbledhëse me gjetjet përkatëse[177]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të larte publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | "Duke marrë në konsideratë faktin se raportet e KSBC-së përmbanin të dhëna sensitive dhe personale, ato bëheshin pjesë e diskutimeve në ato grupe për të cilat Raporti kishte ndikim të drejtpërdrejtë. Raporti në tërësi i shpërndahej drejtuesëve, ndërsa në departamente diskutoheshin vetëm ato pjesë të raporteve që lidheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë me atë department. Në ato raste kur të dhënat vlerësoheshin se kanë një sensibilitet të lartë, rastet trajtoheshin nga strukturat drejtuese me personin konkret në takime individuale". |
| Kriteri 3.Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | "Të dhënat e përftuara nga vetëvlerësimet periodike shërbenin jo vetëm për analizimin e situatës por edhe në indentifikimin e problematikave me synim marrjen e masave për përmirësimin dhe garantimin e cilësisë së brendshme. Skedat e pyetësoreve përpunoheshin përmes programit të përdorur për vlerësimin online dhe i viheshinnë dispozicion drejtueseve të Universitetit, si dhe në mënyrë të personalizuar për secilin pedagog. Të dhënat e fituara nga instrumentet e vetëvlerësimeve periodike, pas përpunimit shfrytëzoheshin gjerësisht në mbështetje të proçesit të follow-up,gjatë të cilit drejtuesit e Universitetit bëjnë vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik. Në bazë të natyrës së problematikave të evidentuara nëpërmjet pyetësoreve, ishin marrë masa, të cilat variojnë nga zhvillimi i seminareve trajnuese dhe deri tek masat konkrete për pedagoget të cilët mund të kenë shfaqur problematikë të vazhdueshme.<br>Në kuadër të politikave të përmirësimit të cilësisë mund të përmendim:<br>-Zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme të fokusuara kryesisht në aspektet didaktike të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor;<br>-Inkurajimi dhe mbështetja e stafit akademik për pjesëmarrjen në aktivitete zhvilluese, si brenda ashtu dhe jashtë vendit;<br>-Bashkëpunimi ndërkombëtar në kuadër të shkëmbimit të stafit në përmjet përfshirjes në programin Erasmus+. |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | Universiteti vlerësonte dhe siguronte efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë nëpërmjet "kontrollit të kryqëzuar" (cross-check) që implementohet nga struktura dhe aktorë të brendshëm të UET, duke filluar nga njësitë bazë nëpërmjet drejtuesit të departamentit, përgjegjësit e grup-lëndëve e koordinatorit të programit, strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional, Zyra e Kurrikulave[178], |

[177] Plani I veprimit KSBC(Ref.nr.30.1)

[178] Dokumenti E.VII Mbi funksionin e Zyres se Keshillimit te Karrieres dhe Kujdesit ndaj Studentit(Ref.nr.12)

| | |
|---|---|
| | Zyra e Standardeve dhe Cilësisë e Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit | Përfshirja e stafit akademik dhe student venë sigurimin e brendshëm të cilësisë garantohej në mënyrëtë drejtpërdrejtë nga përfshirja e tyre në strukturat e garantimit të cilësisë por dhe në mënyrë të tërthortë duke qenë se veprimtaria i bëhej e ditur si stafit akademik ashtu dhe studentëve. Informacioni për studentët shpërndahej nëpërmjet:<br>- Rregulloreve;<br>- Studentëve të përfshirë në struktura të ndryshme brenda institucionit (KSBC, Senatin Akademik);<br>- Këshillit të studentëve;<br>- Javës së orientimit (e cila zhvillohet në fillim të vitit akademik). |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**<u>Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Arteve në "Arte Muzikore" me profilet, "Mjeshtëri Piano", "Mjeshtëri instrumentësh me harqe" i Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti Europian i Tiranës.</u>**

## Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Arteve në "Arte Muzikore" me profilet, "Mjeshtëri Piano", "Mjeshtëri instrumentësh me harqe" është përgatitur në përputhje me nevojat e kohës dhe me interesat kombëtare dhe vlerat kulturore kombëtare i cili synon të kontribuoje për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare.
2. Ky program studimi ofruar nga UET, demostron se është në përputhje me politikën e UET si dhe tregohet qartë në mënyrë të dokumentuar për pikësynimet.
3. UET zoteron një infrastrukturë efiçente për orientimin e studentëve drejt tregut të punës në të cilën përfshihen:
   a) Zyra e Këshillimit të Karrierës së studentëve e cila bashkëpunon me këshilltarët e karrierës së çdo Fakulteti, Departamenti.
   b) Bordi i tregut të punës.
   c) Organizon panaire të punës dhe aktivitete me aktorë të tregut të punës.

d) Dërgon njoftime në mënyrë permanente tek studentët mbi mundësi të ndryshme punësim.

4. UET demostron një infrastrukturë juridiko-administrative efikase e cila pasqyrohet në paraqitjen dokumentare të gjithë dokumentacionit e paraqitur.

## Pika të dobëta

1. Profili i diplomës nuk mund të qëndroj në modulin C pasi është vlerë e modulit B dhe një pjese e Lëndëve Karakterizuese te moduli B duhet të integrohen në një koncept ndyshe. **(Standarti I.2/kriteri 3; standarti II.1/kriteri 2)**
2. Diploma me profil "Mjeshtri në Piano"dhe "Mjeshtri në Instrumenta me Harqe" janë emertësa që nuk egzistojnë në terminologjinë e syllabuseve dhe kur i krahason me emërtesat e programeve të studimit të universiteteve si brenda dhe jashtë vendit është një fakt me shumë, në veshtirësitë e njohjes dhe ekuivalentimit të ECTS-ve në rast transferimi të studentëve nga një universitët në një tjetër. **(Standarti I.2/kriteri 3; standarti II.1/kriteri 2)**
3. Syllabuset si mëposhtë janë të papërditësuara dhe të ngjashme me programin e Bachelorit:
   a) Syllabusi "Mjeshtri Piano ½"
   b) Syllabusi "Mjeshtri instrumentash me harqe II-III"
   c) Syllabusi " Mjeshtri Instrumentash me harqe III"
   d) Syllabusi "Kompozicionit I&II"
   e) Syllabusi "Teori e Muzikës dhe solfezh". **(Standarti I.3/kriteri 1; standarti II.1/ kriteret 2; standarti II.4/ kriteri 2, 3, 4, 5)**

## Rekomandime

1. GVJ duke u referuar ne VKM nr.41, datë 24.01.2018 sugjeron që lëndët, praktika profesionale dhe detyrimet përmbyllëse (punimi i diplomës/provimi i përgjithshëm përfundimtar, të organizuara sipas karegorive respektive A-E, të gjitha këto lëndë të kenë një ristrukturim të ri, sepse Profili i diplomës nuk mund të qëndroje në modulin C, pasi është vlerë e modulit B dhe një pjese e Lëndëve Karakterizuese te moduli B duhet të integrohen në një koncept ndyshe pasi ky profil diplome studentit i nxjerr problem në tregun e punës pasi elementi i parë i numrit të 36 ECTS-ve nuk është i mjaftueshëm për të konkuruar denjësisht në tregun e punës.

2. GVJ sugjeron që Diploma me profil "Mjeshtri në piano"dhe "Mjeshtri në instrumenta me harqe" janë emertësa që nuk egzistojnë në terminologjinë e syllabuseve dhe kur i krahason me emërtesat e programeve të studimit të Universiteteve si brenda dhe jashtë vendit është një fakt me shumë, në veshtirësitë e njohjes dhe ekuivalentimit të ECTS-ve në rast transferimi të studentëve nga një universitët në një tjetër.
3. GVJ sugjeron që:

   a) Syllabusi "Mjeshtri Piano ½" duhen riparë pasi janë copy-paste: Masteri me Bachelorin.
   b) Në syllabusin "Mjeshtri instrumentash me harqe II-III" duhen riparë pasi janë copy-paste Masteri me Bachelorin.
   c) Syllabusi "Mjeshtri Instrumentash me harqe III" duhen riparë temat e përfshira në të pasi janë të kufizuara dhe nuk i shërbejnë studentit për tregun e punës pasi janë kapituj të ndryshëm nga "Estetika me tre pamje".

d) Syllabusi "Kompozicionit I&II" duhen riparë pasi janë "kombinime" me copy paste midis Bachelorit dhe Masterit. Temat e përfshira në të janë të kufizuara dhe nuk i shërbejnë studentit për tregun e punës.
e) Syllabusi i Solfezhit, lënda mund të riemertohet "Teori e Muzikës dhe Solfezh".
f) Në lëndët karakterizuese për ti shërbyer më shumë njohurive të thelluara dhe të jetë një bazë e sigurt për ciklin e tretë duhet të gjendet mundësia për marrje dijesh në lëndë shumë të rëndësishme si: Polifoni, analizë forme, semiotike, semantike,orkestër, klase opere, lexim partiture, deshifrazh etj, pasi janë lëndë karakterizuese me peshë specifike që në formimin e studentit me "dije të thelluara" përbejnë një domosdoshmëri dhe janë lëndë që rrisin sigurinë për transferimin e sigurtë të tyre në IAL paralele si brenda dhe jashtë vendit.

4. GVJ sugjeron që në modulin B nevojitet që profilet e diplomës, të ndryshojnë modul nga C-ja te B-ja me analizën e syllabuseve, pasi bëhen të domosdoshme, sikurse edhe Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rinisë (Drejtoria e Derregullimit, Licencave dhe Monitorimit) me Nr.11373 Prot me datë 29.10.2018 i rekomandon UET-it ku citon që: "Rekomandimet e ekspertëve nevojiten të plotësohen para fillimit të veprimatrisë së programit të studimit përkatës,ndërsa rekomandimet për sigurimin e marrëveshjeve të bashkepunimit me institucione të tjera për zhvillimin e praktikave profesionale,të sigurohen të paktën një muaj para fillimit të tyre."

**Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Master of Arts in "Musical Arts" with the profiles, "Piano Mastery", "String Mastery" of the Institution of Higher Education, European University of Tirana.**

### Strengths and Affirmations

1. The study program of the second cycle Master of Arts in "Musical Arts" with the profiles, "Piano Mastery", "String Instrument Mastery" has been prepared in accordance with the needs of the time and with national interests and national cultural values which aims to contribute to the development of knowledge in Albanian society.
2. This program of study offered by UET demonstrates that it is in accordance with the policy of UET and is clearly indicated in a documented manner for the objectives.
3. UET has an efficient infrastructure for the orientation of students towards the labor market, which includes:
   a) Student Career Counseling Office which cooperates with the career counselors of each Faculty, Department.
   b) Labor market board.
   c) Organizes job fairs and activities with labor market stakeholders.
   d) Sends notices permanently to students on various employment opportunities.
4. UET demonstrates an efficient legal-administrative infrastructure which is reflected in the documentary presentation of all submitted documentation.

## Weak points

1. The profile of the diploma cannot stay in module C as it is the value of module B and a part of the Characteristic Subjects in module B must be integrated into a single concept. **(Standard I.2/criterion 3; standard II.1/criterion 2).**
2. Diplomas with the profile "Master in Piano" and "Master in Stringed Instruments" are designations that do not exist in the terminology of the syllabuses, and when you compare them with the designations of study programs at universities both inside and outside the country, it is one more fact in the difficulties of recognition and equivalence of ECTS in case of transfer of students from one university to another. **(Standard I.2/criterion 3; standard II.1/criterion 2)**
3. The syllabi as below are not updated and similar to the Bachelor's program:
   a) Syllabus "Master Piano ½"
   b) Syllabus "Master of bowed instruments II-III"
   c) Syllabus "String Master III"
   d) Syllabus "Composition I&II"
   e) Syllabus "Music Theory and Solfeggio" **(Standard I.3/criterion 1; standard II.1/criterion 2; standard II.4/criteria 2, 3, 4, 5)**

## Recommendation

1. GVJ referring to VKM no. 41, dated 24.01.2018, suggests that the courses, professional practice and final obligations (diploma thesis/final general exam, organized according to the respective positions A-E, all these courses have a restructuring new, because the degree profile could not stay in module C, as it is a value of module B, and part of the Characteristic Subjects in module B should be integrated into a different concept, since this degree profile poses a problem to the student in the labor market as the first element of the number of 36 ECTS is not enough to compete decently in the labor market.
2. GVJ suggests that the Profile Diploma "Piano Master" and "String Master" are names that do not exist in the terminology of the syllabuses and when you compare them with the names of study programs of Universities both inside and outside the country, it is a fact with many, in the difficulties of recognition and equivalence of ECTS in case of transfer of students from one university to another.
3. GVJ suggests that:
   a) The "Piano Master ½" syllabus must be repaired as they are copy-paste: Master's with Bachelor's.
   b) In the syllabus "Master of stringed instruments II-III" they need to be repaired as they are copy-pasted Master's with Bachelor's.
   c) Syllabus "Master of Bowed Instruments III" the topics included in it should be revised as they are limited and do not serve the student for the job market as they are different chapters from "Aesthetics with three views".
   d) The "Composition I&II" syllabus should be revised as they are "combinations" with copy paste between Bachelor and Master. The topics included in it are limited and do not serve the student for the labor market.
   e) Syllabus of Solfeggio, the subject can be renamed "Music Theory and Solfeggio".
   f) In the characteristic subjects, in order to serve more in-depth knowledge and be a safe basis for the third cycle, there should be the opportunity to acquire knowledge in very important subjects such as: polyphony, form analysis, semiotics, semantics, orchestra, class opera, score reading, decoding, etc., as they are characteristic subjects with specific weight that are a necessity in the

formation of the student with "in-depth knowledge" and are subjects that increase the security for their safe transfer to parallel HEIs both inside and outside the country.

4. GVJ suggests that in module B it is necessary that the diploma profiles change the module from C to B with the analysis of the syllabuses, as they become necessary, as well as the General Regulatory and Compliance Directorate for Education, Sports and Youth ( Directorate of Deregulation, Licenses and Monitoring) with No. 11373 Prot dated 29.10.2018 recommends to UET where it cites that: "The recommendations of the experts need to be completed before the start of the activity of the relevant study program, while the recommendations for securing agreements of cooperation with other institutions for the development of professional practices, to be ensured at least one month before their start."

## Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | X | |
| II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | X | |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBESHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | X | |